



Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, 2009

Aleanca për fëmijët, Shqipëri
Observatori për të drejtat e fëmijëve

unicef



ALEANCA PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
Albanian Children's Alliance



Aleanca për fëmijët, Shqipëri
Observatori për të drejtat e fëmijëve



Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, 2009

Aleanca për Fëmijët në Shqipëri / Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

"Aleanca për Fëmijët në Shqipëri (ACA)" u themelua në vitin 2000 me mbështetjen dhe inkurajimin e organizatave ndërkombëtare UNICEF, "Save the Children dhe "Plan International Albania". ACA ka për qëllim nxitjen e përpjekjeve dhe reformave në nivel qendror dhe lokal, në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.

Një nga projekt aktuale që **"Aleanca për Fëmijët Shqipëri"** po zbaton që nga viti 2009 me mbështetjen e UNICEF – Shqipëri, është "Observatori për të Drejtat e Fëmijës", i cili ka për qëllim mbledhjen e informacionit mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri si edhe analizën e tij, forcimin dhe harmonizimin e bashkëpunimit për të rritur përpjekjet efektive për realizimin e të drejtave të fëmijës nën nismën "Çështja e fëmijëve është çështje e të gjithëve". Objektivi tjetër i Observatorit është të kontribuojë për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në 12 Qarqet e vendit, nëpërmjet mekanizmave të shoqërisë civile me qëllim rritjen e pjesëmarrjes qytetare në hartimin e politikave për të drejtat e fëmijëve.

■ Observatori për të Drejtat e fëmijëve

Observatori prezanton raportin për vitin 2009, në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve në 8 Qarqe të Shqipërisë. Ky raport synon që të kontribuojë në zhvillimin e politikave publike lokale dhe strategjive, - në shërbim të interesit më të lartë të fëmijës. Të gjithë informacionet dhe të dhënat e këtij raporti janë marrë nga institucione zyrtare të nivelit qendror, rajonal dhe lokal. Informacioni është përpunuar në programin DevInfo. Ky botim mundësohet falë bashkëpunimit të UNICEF (Zyra për Shqipërinë), specialistëve të Observatorit Kombëtar dhe ekspertëve të tjerë të jashtëm.

Publikimet e ACA/ Observatori, të cilat përfshijnë një mori të gjerë opinionesh, shërbejnë dhe si kontribute për debate publike kombëtare në lidhje me *çështjen e fëmijëve*. Për këtë arsye, ACA/ Observatori mund të realizojë botime të cilat jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat e UNICEF. Opinionet e shprehura, janë mendimet dhe gjetjet e autorëve dhe janë publikuar nga UNICEF me qëllim për të stimuluar debate dhe bashkëpunime për të drejtat e fëmijës.

Kërkesa apo leja për të ri-prodhuar apo përkthyer raportin e ACA/ Observatorit duhet që t'i adresohen zyrës kryesore ACA/ Observatorit në adresën e më poshtme: albchildnet@albmail.com dhe observatory_tir@yahoo.com.

Për të patur këtë raport në format elektronik, ju mund ta gjeni atë në faqen e ACA/ Observatorit: www.aca.org.al.

Adresa postare e ACA/ Observatorit është:

Observatori Kombëtar, Zyra Qendrore në TIRANË

Bulevardi "Bajram Curri"

Pallatet Agimi

Shkalla 5, Ap. 81.

Tiranë, Shqipëri

Tel. 04 22 58 987

e-mail: albchildnet@albmail.com

e-mail: observatory_tir@yahoo.com

www.aca.org.al

© 2011 United Nations Children's Fund (UNICEF)

Punimi grafik nga: shtypshkronja PEGI

Botuar nga: shtypshkronja PEGI

Përmbajtja

Parathënie	5
Falënderime	6
Lista e shkurtimeve	7
Përshkrim i përgjithshëm për raportin	8
Hyrje	9
Kapitulli 1	12
1.1. Analiza e mbledhjes së të dhënave	12
1.2. Kufizime të raportit	13
1.3. Analiza e situatës në Shqipëri	14
Kapitulli 2. Qarku i Dibrës	22
Kapitulli 3. Qarku i Durrësit	37
Kapitulli 4. Qarku i Elbasanit	44
Kapitulli 5. Qarku i Gjirokastrës	57
Kapitulli 6. Qarku i Korçës	68
Kapitulli 7. Qarku i Kukësit	83
Kapitulli 8. Qarku i Shkodrës	96
Kapitulli 9. Qarku i Vlorës	113
Rekomandime	121

Parathënie

Të drejtat e fëmijëve janë çështje e të gjithëve. Shumica e zyrtarëve, biznesmenëve, artistëve, njerëzve të shquar, qytetarëve dhe prindërve, me lehtësi pranojnë pjesën e tyre të përgjegjësisë kur flitet për të drejtat e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre. Gjithashtu, në krahasim me çështje të tjera, është më e lehtë të arrihet mirëkuptimi kur diskutohet mbi nevojën e rritjes së mirëqenies së fëmijëve.

Por, të transformosh dëshirën e mirë në veprime konkrete për të përmirësuar jetesën e fëmijëve, është një çështje krejtësisht tjetër. Të garantosh se të gjithë fëmijët gëzojnë të drejtat e tyre ashtu siç parashikohet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve është një ndërmarrje serioze. Ajo kërkon profesionalizëm, informacion të detajuar, analizë dhe dialog.

Shpesh ekzistojnë pikëpamje të ndryshme mbi të njëjtën çështje. Ndërsa disa konsiderojnë nivelin e lartë të regjistrimit në shkollë, të tjerë mendojnë për fëmijët e braktisur. Ndërsa disa kërkojnë përdorimin eficient të burimeve publike, të tjerë analizojnë përjashtimin shoqëror të fëmijëve. Kudo në botë, ekziston pikëpamja e qeverisë, këndvështrimi i shoqërisë civile, pikëpamja e ekspertëve të pavarur si edhe pikëpamja e atyre që janë drejtëpërsëdrejti pjesë e të njëjtës çështje. Sa më shumë të dhëna të besueshme që të kemi, aq më e madhe është mundësia që të gjithë partnerët të gjejnë mirëkuptim në funksion të formulimit të zgjidhjes më të mirë.

Observatorët për të drejtat e fëmijëve tani ekzistojnë thuajse në të gjitha qarqet e Shqipërisë. Shpresoj se së shpejti ato do të funksionojnë në të gjitha qarqet e Shqipërisë. Ato drejtohen nga shoqëria civile, ekspertët e të cilës mbledhin informacion mbi fëmijët dhe problemet e tyre dhe e analizojnë atë nëpërmjet lenteve të shoqërisë civile. Në shumicën e rasteve, stacionet e observatorëve bashkëpunojnë ngushtësisht me nëpunësit e administratës publike. Disa këshilla rajonale kanë siguruar edhe zyrat për observatorët, sepse ato besojnë në vlerën që observatorët mund të sjellin në hartimin e planeve rajonale dhe diskutimet e këshillave rajonale mbi politikat dhe buxhetet.

Kam kënaqësinë të prezantoj raportin e parë të përbashkët të tetë observatorëve për periudhën 2009 dhe pjesërisht 2010. Ata sjellin një pasqyrë të situatës së fëmijëve në rajonet e tyre përkatëse, sipas një formati standard për të krijuar lehtësi krahasimi. Shpesh të dhënat janë të detajuara edhe në nivel rrethi, bashkie e komune, e si të tilla mund të shërbejnë për një planifikim më të thelluar sipas nevojave lokale.

Në raportet e ardhshme, tipe të reja informacioni do të shtohen. Një pjesë e informacionit mbase është e njohur edhe tani, një pjesë tjetër e informacionit do të jetë e re. Disa të dhëna mund të pranohen lehtësisht, disa të tjera mund të diskutohen. Sidoqoftë, unë jam i sigurtë se raporti do të mirëpritet dhe do të shihet si një kontribut i paçmuar që shërben për të diskutuar në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar politikat mbi fëmijët. Unë shpresoj se ky botim do t'i ndihmojë të gjithë partnerët që të bashkohen fuqishëm rreth të drejtave të fëmijëve.

Detlef Palm

Përfaqësues i UNICEF

Falënderime

Për realizimin e këtij raporti punuan dhe dhanë kontribute një grup i gjerë ekspertësh në nivel lokal dhe të Institucioneve të ndryshme (në nivel qendror, lokal dhe në nivel qarku).

Në sajë të punës së përkushtuar të specialisteve të Observatorit në 9 Qarqe u arrit hartimi i raportit. Më konkretisht përmendim:

- Majlinda Hoxha, Zyra e Observatorit, - Qarku Dibër
- Izolda Canka, Zyra e Observatorit, - Qarku Durrës
- Artan Kruja, Zyra e Observatorit, - Qarku Elbasan
- Eglantina Gjini, Zyra e Observatorit, - Qarku Gjirokastrë
- Marjana Jorgji, Zyra e Observatorit, - Qarku Korçë
- Shkëlqim Muca, Zyra e Observatorit, - Qarku Kukës
- Anilda Gurakuqi, Zyra e Observatorit, - Qarku Shkodër
- Jonida Rustemaj, Zyra e Observatorit, - Qarku Vlorë

Një falënderim i veçantë është dhe për stafin më të ri të Observatorit në zyrën e Tiranës, të cilat kanë dhënë një kontribut të pa kursyer në hedhjen e të dhënave në Dev Info:

- Mina Mata,
- Megi Thomallari

Grafiket dhe tabelat e këtij projekti janë përgatitur nga Znj. Mina Mata.

Ky raport u përpunua grafiksht dhe teknikisht, dhe u përpilua nga Znj. Elma Tërshana, Drejtore Projekti, Observatori Tiranë.

Ju jemi mirënjohës gjithashtu dhe përfaqësuesve të Institucioneve të ndryshme lokale dhe qendror, përfaqësues të shoqërisë civile në vend për kontributin dhe bashkëpunimin institucional që i kanë ofruar zyrave të Observatorit përgjatë kësaj periudhe.

Ky publikim u mundësua falë punës së bërë nga :

- Sahli Hamzaj, redaktor
- Mimoza Gjika, përkthyes
- Iain F.Wilson , redaktor i raportit në anglisht.

Dhe së fundmi gjejmë rastin për të falënderuar stafin drejtues të këtij projekti Znj. Suzana Sakiqi, (Koordinatorë kombëtare - ACA), bordin e "Aleancës Kombëtare për Fëmijë", Znj. Arlinda Ymeraj (UNICEF) dhe Znj. Eliana Paravani, për gatishmërinë dhe kontributet e pa kursyera në çdo kohë.

Lista e shkurtimeve

ACA	Aleanca Shqiptare për Fëmijë
IShP	Instituti i Shëndetit Publik
MPÇSShB	Ministria e Punës, e Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta
OJF	Organizata jofitimprurëse
DAR	Drejtoria arsimore rajonale
DRShS	Drejtoria rajonale e shërbimeve sociale
DShP	Drejtoria e shëndetit publik
IHD	Indeksi i zhvillimit njerëzor
UNICEF	United Nations Children's Fund(Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët)
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
NE	Ndihma ekonomike
ZA	Zyra arsimore

Përshkrim i përgjithshëm për raportin

Observatori për të drejtat e fëmijëve është një projekt i Aleancës Shqiptare për Fëmijë, i mbështetur financiarisht nga zyra e UNICEF-it, Shqipëri. Zbatimi i këtij projekti ka filluar në nëntor 2008, duke u shtrirë tashmë në qarqet Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, dhe duke synuar shtrirjen në të gjithë Shqipërinë deri në fund të vitit 2011. Nga zbatimi i këtij projekti, synohet të ngrihen mekanizma për vëzhgimin e mbledhjen e informacionit dhe për realizimin e raportit të situatës së të drejtave të fëmijëve në secilin qark.

Zyrat e Observatorit funksionojnë si struktura të shoqërisë civile që kanë për qëllim forcimin e aleancave dhe harmonizimin e bashkëpunimit të të gjithë aktorëve të mundshëm për të rritur përpjekjet efektive për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Misioni i punës së Observatorit është sa institucional, aq dhe shoqëror. Grupi i realizimit të projektit përbën, në fakt, një zyrë të hapur dhe një mundësi më shumë për qytetarët dhe vetë fëmijët që të marrin pjesë në hartimin e politikave publike dhe sociale që mbrojnë interesat e fëmijëve. Nëpërmjet punës si Observator, identifikohen problemet kritike që cenojnë realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Observatori për të drejtat e fëmijëve është një mekanizëm lokal dhe kombëtar, i aftë për të tërhequr rreth vetes të gjithë aktorët dhe vetë fëmijët nën nismën "Çështja e fëmijëve është çështje e të gjithëve".

Observatori për të drejtat e fëmijës (Observatori) paraqet raportin e tij të dytë "*Realizimi i të drejtave të fëmijëve në Shqipëri - 2009*". Për hartimin e këtij raporti kanë punuar intensivisht ekspertë të Observatorit në të gjitha qarqet ku funksionojnë zyrat e tij në bashkëpunim të ngushtë me zyrën bashkërenduese të Observatorit në Tiranë dhe me Aleancën kombëtare për fëmijë. Informacioni i paraqitur dhe i përpunuar në këtë raport është bazuar në informacionet e marra nga intervistat me përfaqësues kyç të institucioneve lokale në këto rajone, nga të dhëna numerike nga vetë këto institucione, si dhe nga intervista dhe kontakte me struktura komunitare.

Ky raport synon që të jetë me fushë të gjerë përdorimi. Të dhënat e tij mund të shfrytëzohen në nivel lokal sipas interesit nga njësitë dhe strukturat lokale, njësitë e qeverisjes vendore, OJF-të, shkollat, donatorët e orientuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve etj. Publikimi i këtij raporti synon të përpunojë informacione sipas këndvështrimit të shoqërisë civile, si dhe të nxisë diskutimet e grupeve të interesit për realizimin gjithëpërfshirës të të drejtave të fëmijëve në shoqërinë tonë.

Ky raport përmban të dhëna në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve në qarqe, duke i paraqitur ato deri në nivel bashkie dhe komune. Të drejtat që janë pjesë e këtij procesi monitorimi, përfshijnë: të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtën për edukim, të drejtën për mbrojtje shoqërore, dhe të drejtën për pjesëmarrje. Informacioni i përpunuar në këtë studim është mbështetur kryesisht në statistikat përkatëse të vitit 2009, duke synuar që të jetë një analizë konstruktive për të ndihmuar institucionet vendore për një përmbushje dhe përjasje më profesionale dhe të plotë të të drejtave të fëmijëve.

Përmbushja e detyrimeve, që dalin nga Konventa për të drejtat e fëmijëve dhe nga legjislati ynë, nuk do të ishte e mundshme dhe e frytshme, nëse ato do të zbatoheshin vetëm në nivel qendror, duke përjashtuar pushtetin vendor, i cili është më afër komunitetit dhe problemeve të tij.

Trajtimi i raportit në këto nivele, lidhet me thellimin e decentralizmit, sidomos me rritjen e përfshirjes së qeverisjes vendore në hartimin e politikave lidhur me zbatimin konkret të të drejtave të fëmijëve. Një dukuri e tillë ka nxjerrë si domosdoshme përfshirjen më të madhe dhe më me përgjegjësi të organeve të pushtetit vendor në këtë veprimtari të rëndësishme, nëpërmjet ndërmarrjes së hapave konkretë.

Hyrie

Observatorët për të drejtat e fëmijëve, si struktura të shoqërisë civile, që po veprojnë në qarqet e përmendura më sipër, u ngritën si një nevojë emergjente në vend për shkak të mungesave të theksuara të të dhënave për problemet e ndryshme që lidhen me gjendjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve në komunitete të ndryshme, si dhe për monitorimin e tyre në nivel komune, bashkie dhe qarku. Duke e vlerësuar tepër të rëndësishëm faktin që realizimi i të drejtave të fëmijëve sipas Konventës përkatëse, është e drejtë e çdo fëmijë në Shqipëri, pavarësisht qytetit apo fshatit ku ai jeton, prania e një organizmi të tillë si Observatori për të drejtat e fëmijëve në qark, siç do të dalë edhe nga veprimtaria konkrete e tij, e trajtuar në vazhdim, del se është e domosdoshme. Konkretisht, të gjitha zyrat e Observatorit kanë mbledhur dhe kanë përpunuar informacione, në bazë të të cilave kanë zhvilluar analiza të plota, bazuar në situata dhe të dhëna në nivel qarku, të dhëna të cilat kanë mundësuar matjen e përshtatjes dhe të ndikimeve të politikave kombëtare në kushte të ndryshme të jetesës në çdo qendër banimi, në zona urbane e rurale, duke krijuar kështu mundësi edhe për ndërmarrjen e masave të frytshme që ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha nivelet.

Për sa më sipër, Observatorët për të drejtat e fëmijëve në punën e tyre kanë synuar ndërtimin e një sistemi që monitoron realizimin e të drejtave të fëmijës në nivel lokal, veprim ky që po shërben si pikënisje dhe nxitje për hartimin e politikave e të strategjive zonale përfshirëse e miqësore me fëmijët dhe për fëmijët¹, si dhe për ndërgjegjësimin e organeve të pushtetit e të opinionin shoqëror për përfshirjen në veprimtari konkrete. Ky sistem është bazuar në një sërë treguesish konkretë për zbatimin e të drejtave bazë të fëmijëve, të mbështetura në politika lokale, kombëtare dhe globale.

Duke e vlerësuar të rëndësishme ngritjen dhe funksionimin e zyrave të tilla observuese në qarqe, si dhe duke synuar mbledhjen e të dhënave nga organet përkatëse të pushtetit lokal, zyrat e Observatorëve kanë realizuar një sërë marrëveshjeshe institucionale bashkëpunimi dhe partneritete me to. Bashkëpunimi institucional me struktura të qeverisjes qendrore dhe lokale ka ardhur duke u përmirësuar nga viti 2008. Gjatë viteve 2008 & 2009 zyrat e Observatorëve në qarqe hartuan marrëveshje bashkëpunimi kryesisht me strukturat lokale². Ky proces i hartimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me bashkitë dhe komunat është në vazhdim.

Observatori Kombëtar, pavarësisht se është realizuar nëpërmjet ngritjes së zyrave në çdo qark, synohet që të jetë një strukturë e njësuar në nivel kombëtar. Për këtë qëllim është ngritur një rrjet komunikimi intensiv mes të 9-ta zyrave të Observatorit, si dhe realizohen trajnime, vizita për shkëmbim përvoja dhe takime pune të përbashkëta.

Gjatë viteve të para të veprimtarisë së tyre (2008 & 2009), Observatorët janë vlerësuar si zyra burimore, të cilat me vëmendjen e tyre të veçantë në realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qarku, bashkie dhe komune, bënë të mundshme që fëmijët dhe problemet e tyre të jenë pjesë e angazhimeve ditore të këtyre strukturave³.

Përgatitur nga "Observatori për të Drejtat e Fëmijëve"

Tiranë, 10 maj 2011

¹ Ang: Child Friendly policy

² Ndër struktura kryesore lokale, janë këto institucione: qarku, bashkitë në qark, policia, materniteti, zyra statistikore në rreth (qark), drejtoria arsimore rajonale (DAR), drejtoria rajonale e shërbimeve sociale (DRShS), drejtoria e shëndetit publik (DShP), DRSKSh, drejtoria rajonale e punësimit, njësia për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku, njësia për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkie, komunat në nivel qarku etj.

³ Ky vlerësim është bërë nga kryetari i komunës së Kastriotit, Dibër, nëntor 2009.

➔ **Mënyra e përpunimit të të dhënave dhe hartimi i raportit**

Monitorimi i të drejtave të fëmijëve nga zyrat e Observatorit në nivel lokal (Qarku) dhe në nivel Kombëtar bëhet duke u bazuar në 4 drejtimit kryesore të të drejtave të fëmijëve të përcaktuara në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve si vijon :

- E drejta për mbijetesë dhe shëndet
- E drejta për edukim dhe zhvillim
- E drejta për mbrojtje sociale.
- E drejta për pjesëmarrje.

Hapat e ndjekura për hartimin raportit të monitorimit.

■ **Konceptimi i treguesve**

Treguesit e të drejtave të fëmijëve janë përcaktuar paraprakisht nga eksperte të fushës, bazuar në drejtimit kryesore të të drejtave të fëmijëve. UNICEF ka siguruar ekspertizë teknike të gjerë bazuar mbi standardet ndërkombëtare. Konsultime të gjera me aktorë qeveritarë dhe jo qeveritarë janë organizuar nën drejtimin e UNICEFI-it; si rezultat lista e treguesve në përgjithësi u pranua.

■ **Burimi dhe mbledhja e informacionit**

Të dhënat mbledhen nga specialistët e Observatorëve në secilin Qark nga çdo Bashki dhe Komunë që bëjnë pjesë në Qark.

Si burime informacioni shërbejnë institucionet në nivel lokal, si: Zyrat e Ndihmës dhe Shërbimit Social në Bashki dhe Komuna, Zyrat e Policisë, Zyrat e Shëndetit Publik, Drejtoritë Rajonale Arsimore, Zyrat e Punës, Inspektorati i Punës, Inspektorati i Shërbimeve Sociale, etj.

Si burime informacioni në nivel Qendror shërbejnë institucionet : Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Inspektorati Kombëtar i Punës etj.

Të dhënat që kanë të bëjnë me popullsinë janë marrë nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Burim tjetër i rëndësishëm informacioni janë dhe organizata të shoqërisë civile që operojnë në vende të ndryshme dhe që merren me zbatimin të drejtave të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.

Gjithashtu, ky raport është hartuar bazuar në raporte, studime, kërkime të botuara nga institucione, individë, organizma kombëtare dhe ndërkombëtare.

Procesi i mbledhjes së të dhënave bëhet gjatë gjithë vitit, derisa institucionet të jenë të disponueshëm për ti ofruar ato.

■ **Përpunimi i të dhënave dhe treguesve**

Shumica e të dhënave dhe treguesve që mbledhen, nga burimet e lartpërmendura, në të shumtën e rasteve janë në njësinë matëse "numër". Për shkak se raporti është edhe krahasues, dhe vë theksin tek problematikat e Qarkut, njësia matëse "numër" nuk është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për qëllimet e Observatorit. Për këtë arsye pjesa më e madhe e të dhënave që mbledhen përpunohen nga specialistët e Observatorëve.

Të dhënat përpunohen duke u kthyer në njësinë matëse "përqindje ". Treguesit që kthehen në përqindje bazohen në numrin total të popullsisë ose në numrin e popullsisë të ndarë sipas grup-moshave (kjo në varësi të treguesit). Në këtë mënyre baza krahasimore dhe nxjerrja e problemeve bëhet më e thjeshtë dhe më e kuptueshme. Specialistët e Observatorëve i transferojnë të dhënat në sistemin DevInfo, i cili është sistemi me të cilin ato punojnë.

Të gjithë të dhënat mblidhen në zyrën qendrore në Tiranë, ku administruesi i të dhënave i transferon ato në data –baze qendror të sistemit DevInfo. Sistemi DevInfo nxjerr grafike, harta, gjithashtu dhe rezultate që ndihmojnë për të kuptuar më mirë, për të monitoruar dhe analizuar situatën e të drejtave të fëmijëve në Qarqe të ndryshme.

■ Hartimi raportit

Faza e fundit, bazuar në numra, përqindje, fakte, harta grafike dhe rezultate është hartimi raportit të monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku dhe më pas në nivel Kombëtar.

Ky raport analizon dhe përmban të dhëna për vitin 2009. Vetëm treguesit që kanë të bëjnë *me të drejtën për arsim*, i përkasin periudhës Shtator 2009 – Qershor 2010.

Kapitulli

1

1. Analiza e mbledhjes së të dhënave

Shoqëria shqiptare dhe institucionet shtetërore kanë bërë një progres të dukshëm në realizimin e të drejtave të fëmijëve në vend, krahasuar kjo me standardet dhe politikat evropiane. Nismat ligjore të realizuara në vendin tonë janë të shumta. Ndër to, më kryesoret janë:

- Decentralizimi i shërbimeve sociale në Shqipëri⁴;
- Mbrojtja e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual⁵;

Tabloja legjislativë në vend shpaloset me ndryshime pozitive, të cilat po synojnë plotësimin e kuadrit ligjor për një mbrojtje sa më të mirë të fëmijëve. Nga ana tjetër, janë ndërmarrë dhe nisma për zbatimin e këtyre ligjeve në nivel vendor, si dhe për ngritjen e strukturave përkatëse në këto nivele. Edhe ngritja e funksionimi i zyrave të Observatorëve në nivel qarku, po synon që nëpërmjet monitorimit të situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve, t'i orientojë strukturat e pushtetit vendor për të hartuar dhe për të zbatuar politika dhe strategji lokale sipas nevojave specifike në rajonin e tyre.

Zyrat e Observatorit për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku, falë mbështetjes së UNICEF-Shqipëri, funksionojnë me kapacitet të plotë gjatë gjithë vitit, duke qenë të pranishme në takime me aktorë të ndryshëm lokalë, në veprimtari të ndryshme publike me fëmijët dhe duke dhënë ndihmesë konkrete për mirëqenien e tyre, si dhe për dhënien e ekspertizës për hartimin e dokumenteve strategjike lokale për të drejtat e fëmijëve⁶. Me përparësi janë ndjekur veprimtaritë për shkëmbim përvoja dhe të dhënash me struktura të ndryshme lokale, në trajnime dhe takime që organizohen nga zyra qendrore e Observatorit në Tiranë. I gjithë ky proces pune, po synohet të jetë dinamik, gjithëpërfshirës dhe i realizueshëm në kohë, falë rrjetit të komunikimit (on-line) që funksionon si bazë e procesit të punës. Zyrat e Observatorëve, veç mbledhjes së të dhënave, kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe në mbrojtje të drejtpërdrejtë të të drejtave të fëmijëve dhe kanë ndihmuar në nivel lokal për zgjidhjen e rasteve të ndryshme.

Përgjatë punës së tyre, ekspertët e Observatorëve kanë mundur vendosjen e bashkëpunimit dhe realizimin e vëzhgimeve të ndryshme në terren pothuajse në të gjithë territorin e qarkut përkatës. Siç u përmend dhe më lart, ky raport paraqet të dhëna në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qarku deri në nivel komune. Këto vëzhgime dhe të dhëna janë mbledhur duke u bazuar në një sistem treguesish të mirëpërcaktuar që në fillim të ngritjes së Observatorëve. Treguesit janë hartuar duke u mbështetur në *standardet ndërkombëtare* për të drejtat e fëmijëve, si dhe duke u gërshetuar njëkohësisht me realizimin e detyrave të shtruara në strategjinë kombëtare për fëmijë dhe në planin e saj të veprimit.

Këta *tregues monitorimi* janë zbërthyer në 4 grupime kryesore të të drejtave të fëmijëve, që janë:

⁴ Ligji nr. 8652, dt. 31.07.2000 "për qeverisjen lokale", si dhe Ligji nr. 9355, dt. 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet Shoqërore"

⁵ Në prill 2009 u ratifikua Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve Kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual

⁶ Këtu përmendim koordinatore të observatorëve në qarkun e Shkodrës dhe të Dibrës, të cilat janë përfshirë si ekspertë në procesin e hartimit të strategjive për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku

1. E drejta për kujdes shëndetësor;
2. E drejta për arsim;
3. E drejta për mbrojtje sociale;
4. E drejta për pjesëmarrje.

Mbledhja e të dhënave përkatëse për *140 tregues*, me të cilët vepron Observatori, ka rezultuar pjesa më e vështirë e punës në qarqe, në bashki dhe në komuna. Pavarësisht se këta tregues janë hartuar dhe janë planifikuar të mblidhen duke u bazuar në të dhënat që kanë dhe hartojnë zyrat e pushtetit lokal, si detyrim ligjor i tyre, informacioni i vënë në dispozicion nga këto zyra ka qenë i kufizuar me gjithë përpjekjet që janë bërë nga zyrat e Observatorit. Shkaqet pse këta tregues nuk janë mbledhur, janë kryesisht për këto arsye:

- Një pjesë e treguesve të përcaktuar nga Observatori, *nuk përkojnë me formulën* dhe kufizimet moshore që mblidhen nga zyrat lokale;
- Gjithashtu, është vënë re dhe *mungesa e njohurive/kompetencës* për të përdorur metoda kërkimore të ndërthurura, si një alternativë për të matur tregues në nivel qarku.

Këto fakte kanë bërë që nga lista e synuar e *140 treguesve*, të arrihet të merren të dhëna vetëm për *43 tregues* nga zyrat e Observatorit.

2. Kufizime të raportit

Procesi i grumbullimit të të dhënave për hartimin e raportit, vazhdon të mbetet një sfidë e mbarsur me probleme të ndryshme për zyrat e Observatorëve në qarqe. Këto kufizime vazhdojnë të jenë pjesë e vështirësisë së mbledhjes së treguesve në terren, megjithëse tashmë bashkërenduesit lokalë të Observatorit kanë rreth dy vjet përvojë dhe njohuri më të plota në këtë proces. Pengesat që vazhduam të hasim dhe gjatë këtij viti në terren, janë kryesisht:

- Institucionet lokale **nuk** i kanë pjesë të punës së tyre grumbullimin dhe përpunimin e disa dhënave treguese, me të cilët vepron Observatori;
- Institucionet lokale përkatëse nuk mbledhin dhe nuk i bëjnë publike treguesit **për një vit të dhënë në kohë**.
- Disa tregues ofrohen jo të plota nga institucionet lokale, ato herë jepen **në përqindje dhe** herë jepen **në numër** në disa zona brenda një qarku.
- Ndryshimet në personelin e institucioneve lokale shpesh dhe jo në mënyrë të organizuar në rajone të ndryshme në qarqe, krijojnë "hendek" në gjetjen e të dhënave (rekordeve);
- Në disa qarqe, strukturat lokale arsimore nuk demonstrojnë gatishmëri për të bashkëpunuar në dhënien apo në përcjelljen e informacioneve përkatëse tek zyrat e Observatorit.

Vështirësia në mbledhjen e treguesve nga zyrat e Observatorëve, është e shumanshme. Disa nga vështirësitë që hasen më shpesh, janë:

- Një pjesë e treguesve, me të cilët vepron Observatori, nuk përputhen me treguesit dhe të dhënat që mbledhin dhe përpunojnë zyrat lokale.

- Pothuajse të gjithë treguesit ku ne kemi bazuar punën tonë, janë dhënë në shifër të përbashkët për vajzat dhe djemtë, informacion të cilin ne nuk e kishim të mundur ta merrnim nga terreni.
- Me kalimin nga njëri vit në tjetrit, jemi ballafaquar dhe me faktin që kanë humbur të dhënat (sistemi i mbajtjes së të dhënave) në zyrat lokale.

3. Situata e përgjithshme në Shqipëri

Vendi ynë, pas një periudhe të gjatë tranzicioni, tashmë po realizon hapa progresi në të gjitha aspektet e zhvillimit të shoqërisë, duke synuar anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Zhvillimet ekonomike dhe reformat institucionale janë dëshmi e progresit dhe e përpjekjeve të Shqipërisë për t'u afruar me standardet e shoqërive të zhvilluara evropiane. Në këto procese zhvillimi, nuk mungojnë dhe përpjekjet për të përmbushur dhe për të garantuar mirëqenien dhe sigurinë e fëmijëve në vend.

Në opinionin e Komisionit për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian⁷, del qartë se ky aplikim analizohet mbi bazën e aftësisë së vendit për të plotësuar kriteret e përcaktuara nga Këshilli Evropian. Ndër të tjera, në këtë komunikatë, Shqipëria këshillohet të bëjë hapa konkretë në forcimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, të fëmijëve, të romëve, si dhe në zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim.

Vëmendja e institucioneve të varura dhe të pavarura shtetërore ka ardhur në rritje në lidhje me trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mirërritjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Miratimi i Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"⁸, përbën një hap të rëndësishëm legjislativ në mirë përcaktimin e roleve dhe të detyrave ndërministrorë dhe institucionale në garantimin e mirëqenies së fëmijës.

Në raportin e zhvillimit njerëzor të vitit 2010, Shqipëria në statistikën "Treguesi i zhvillimit njerëzor"⁹ renditet në vendin e 64-ët, duke bërë që të ketë një shkallë uljeje krahasuar me vitin 2005 (në vlerën 0,719 HDI, viti 2010). Shkalla e rritjes vjetore të GDP-së për frymë në përqindje për periudhën 1990–2009 është **5,4**¹⁰. Shqipëria është një nga vendet me një popullsisë më të re në Evropë, ku mosha mesatare është 32,8 vjeç¹¹.

Në kuadër të reformave të ndryshme në vend, një vëmendje të veçantë merr zbatimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve. Gjatë këtyre viteve të fundit, dokumentet strategjike dhe planet e veprimit në vazhdimësi janë shoqëruar me shpenzimet përkatëse buxhetore, gjë që tregon se qeveria është përfshirë seriozisht në këtë proces. Nga të dhënat e buxhetit vjetor (2010) për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, te zëri "Arsimi bazë (përfshirë dhe parashkollorin)", për një periudhe trevjeçare (2008, 2009, 2010), në vitin e fundit është shtuar buxheti me 3,5% në krahasim me vitin paraardhës. Kështu, në vitin 2008, arsimi bazë mori 56,9%, për vitin 2009 mori 55,4% dhe në vitin 2010 mori 58,9%¹⁴.

Në raportin e përvitshëm që hartohet nga Avokati i Popullit¹², shikohet një vëmendje e veçantë e këtij autoriteti në lidhje me çështjen e mbrojtjes dhe të garantimit të të drejtave të fëmijëve në vend. Në këtë raport shprehet në mënyrë të veçantë vlerësimi për punën e zyrës së Observatorit të Shkodrës dhe rolin e saj pozitiv në zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

⁷ Komunikatë e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin; Komisioni Evropian, Bruksel, 9 nëntor 2010. COM(2010)680

⁸ Ligji "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës", nr. 10347, datë 4.11.2010

⁹ Ky indeks përlogarit duke u bazuar në tri përmasa në bazë të zhvillimit njerëzor: (1) jetëgjatësia dhe shëndeti, (2) mundësia për arsim dhe (3) standardi i jetesës

¹⁰ The State of the World's Children 2011; Adolescence: An age of opportunity

¹¹ Burimi. INSTAT, Shqipëri

¹² "Avokati i Popullit", Raporti vjetor 2010, faqe 114.

Përmbledhje problemesh :

Në një analizë krahasimore mes rajoneve të ndryshme ku operon Observatori (në nivel qark, bashki apo komunë), janë evidentuar disa probleme, si:

- Në qarkun e Dibrës, komuna e Melanit (e cila ndodhet në afërsi të qytetit) del se është ndër më problematike për vijueshmërinë tepër të ulët të arsimit të detyruar (**grupmosha 6-15 vjeç**), përkatësisht në vlerën **63%** në nivel qarku (për ndjekjen e arsimit të detyruar, shiko shënimin në vazhdim). Gjithashtu kjo komunë ka dhe numrin më të lartë të fëmijëve (6-15 vjeç) të cilët jetojnë në familje të varfra, përkatësisht në vlerën **56,63%**. Pra del qartë se mos vijueshmëria e shkollës lidhet ngushtë edhe me nivelin ekonomik të banorëve të një komuniteti të caktuar.
- Rrethi me numër më të lartë të fëmijëve (6-15 vjeç), të cilët jetojnë në familje të varfra, të krahasuara në nivel kombëtar, është rrethi i Pogradecit me **26,49%** (qarku i Korçës); Po në këtë rreth raportohen dhe zona të cilat kanë dhe një shkallë të ulët regjistrimi në arsimin e detyruar, që janë: bashkia e Leskovikut **42,13%**, komuna e Mollasit **38,12%**, komuna Qendër-Ersekë **37,4%**.
- Komuna me numër më të lartë të fëmijëve (6-15 vjeç), të cilët jetojnë në familje të varfra, të krahasuara në nivel kombëtar në qarkun e Kukësit është komuna Topojan me **84,15%** dhe komuna Bujan, me **76,92%**. Ndërkohë po në këto komuna, në vitin 2009 regjistrohet një vijueshmëri e ulët në arsimin e detyruar, përkatësisht, në komunën Topojan **61,24%** dhe në komunën Bujan **57,17%**.
- Komuna me numër më të lartë të fëmijëve (6-15 vjeç), të cilët jetojnë në familje të varfra, të krahasuara në nivel kombëtar në qarkun e Shkodrës është komuna e Shllakut me **51,48%**. Po në këtë komunë, në vitin 2009 kemi një regjistrim të ulët në arsimin e detyruar në shkallën **28,7%**.

Shënim. Të mbahet parasysh se treguesit e përqindjes së regjistrimit dhe të vijueshmërisë së nxënësve në arsimin e detyruar, në të gjithë rastet, janë nxjerrë bazuar në përllogaritjen e numri fëmijëve që ndjekin shkollën (në fakt), me numrin e përgjithshëm të fëmijëve (sipas grupmoshave përkatëse) bazuar në regjistrat e gjendjes civile. Ndërkohë, një pjesë e këtyre fëmijëve nuk janë më banues në komunën/ bashkinë përkatëse për shkak të lëvizjeve demografike të pakontrolluara. Për momentin nuk mund të përllogarisim se sa është shkalla apo numri i lëvizjeve demografike. Ky shënim është i vlefshëm për të gjithë treguesit e arsimit të detyruar që janë analizuar në vijim.

3.1. Përmbledhje vëzhgimesh të shkallës së regjistrimit në sistemin e arsimit në Shqipëri (viti 2009)

Studime të shumta kanë treguar se ndërhyrja cilësore në fëmijërinë e hershme, ka një normë të lartë kthyeshmërie në arsimin bazë dhe më tej për të gjithë personat që përfitojnë nga kjo ndërhyrje. MASH këto vitet e fundit po ndjek politika nxitëse për të rritur ndjekjen e arsimit parashkollor. Gjatë viteve (2008-2009), MASH ka praktikuar klasat përgatitore për fëmijë 5-6-vjeçar, pra përfshirjen e parashkollorëve të grupit të tretë në arsim të detyrueshëm për nxënësit e ardhshëm.

Arsimi në Shqipëri gjatë vitit 2008 dhe 2009 ka vazhduar të ketë një vëmendje të veçantë nga ana e qeverisë, e cila ka synuar mbi të gjitha integrimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies në të gjithë hallkat e sistemit arsimor, nën moton "Mosha dixhitale". Me gjithë shtrirjen me shpejtësi të këtij projekti në mbarë vendin, ai ende nuk është realizuar në të gjitha shkollat. Por, dhe atje ku ky projekt ka arritur, ka hasur probleme të ndryshme për të përmbushur qëllimet e tij. Si probleme të tilla, përmenden: mungesa e energjisë elektrike, mungesa e një mësuesi ekspert për të dhënë njohuritë kompjuterike, mungesa e linjës telefonike që mundëson pasjen e rrjetit të internetit etj.

Një nismë tjetër e qeverisë është ulja dhe minimizimi i fëmijëve që nuk ndjekin arsimin në vend, nën moton "Braktisja zero". Dukuria e braktisjes vazhdon të jetë e pranishme në zona të ndryshme të Shqipërisë, duke prekur më shumë fëmijët që jetojnë në kushte social-ekonomike të varfërisë ekstreme.


Pavarësisht investimeve të realizuara në shkolla nga viti në vit, infrastruktura brenda mjediseve arsimore vazhdon të jetë problematike pa dallim zone banimi, urbane apo rurale. Në kontaktin e parë me një shkollë të bie në sy mungesa e tualeteve me kushte optimale higjieno-sanitare, mungesa e shërbimit parësor mjekësor në shkolla (dentist dhe infermier), mungesa e mjediseve sportive në një standard optimal funksionimi, si dhe mungesa e sistemeve të ngrohjes dhe të ftohjes. Kryesisht në shkollat e zonave rurale të bie në sy mungesa e kufijve rrethues të shkollës nga mjediset e tjera publike të zonës, mungesa e gjelbërimit, mungesa e bankave të përshtatshme përpos zhvillimit të fëmijës.

E drejta për argëtim dhe lojë e fëmijëve, si një e drejtë që ndikon dhe ndihmon në mirëritjen dhe zhvillimin e tyre, është një e drejtë e munguar apo e mos respektuar në shkolla. Fëmijët në shkolla nuk realizojnë rregullisht orët sportive (brenda planit mësimor), gjë e cila cenon të drejtën e tyre për argëtim dhe lojë sportive, si dhe mundësinë për një zhvillim të shëndetshëm dhe aktiv.

Cilësia e të mësuarit është një element tjetër i rëndësishëm në procesin arsimor në shkollë. Fëmijët që janë pjesë e sistemit të detyruar arsimor në Shqipëri, realizojnë rreth 50 orë mësimi në vit më pak se moshatarët e tyre në vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE). Për vitin 2011 është parashikuar që të realizohen rreth 700 orë mësimi ose 170-175 ditë mësimi në vit. Ndërkohë, po i njëjti tregues për vendet anëtare të BE-së është 750 orë mësimi ose 185 ditë mësimi¹³.

Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor (fëmijët 3-6 vjeç) në nivel qarku paraqitet shumë e ulët. Në shifrat e mëposhtme janë përlllogaritur vetëm zonat të cilat kanë të dhëna përkatëse për këtë grup-moshë, duke mos marrë parasysh zonat për të cilat nuk kemi të dhëna. Kjo për arsye që të mos ndikojnë në përlllogaritjen e vlerës aktuale. Megjithatë, përsëri regjistrimi në arsimin parashkollor është në shifra tepër të ulta, në vlerën në më pak se 50%. Më problematike situata paraqitet në qarkun e Shkodrës me 24,25%.

Grafiku 1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor në qarqet ku operon Observatori, 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

¹³ Planin mësimor i arsimit të detyruar, në udhëzimin e MASH-së për vitin shkollor 2010-2011; gazeta "Panorama", "Shkollat 9-vjeçare, 150 orë mësimi më pak se BE", e premtë 21 janar 2011, fq. 9.

Në lidhje me analizën e shkallës së regjistrimit në arsimin e detyruar (6-15 vjeç) në nivel qarku, Dibra (83,76%) dhe Kukësi (83,05%) kanë nivelin më të lartë të regjistrimit. Vlerën më të ulët e ka qarku i Vlorës me 49,35%.


Grafiku 2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar në qarqet ku operon Observatori, 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm (15-18%) në nivel qarku për vitin 2009 paraqitet e lartë në qarkun e Dibrës me 81,47%, duke mbajtur pothuajse të njëjtin nivel me regjistrimin në arsimin e detyruar. Qarku i Shkodrës (43,31%) dhe qarku i Vlorës (47,15%) përmbajnë shkallën më të ulët të regjistrimit, në krahasim me qarqet e tjera.

Grafiku 3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm në qarqet ku operon Observatori, 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

3.2. Përmbledhje vëzhgimesh për të drejtën e mbrojtjes sociale në Shqipëri, viti 2009

Qeveria Shqiptare ka hartuar një sërë politikash që synojnë përmirësimin e skemës së ndihmës ekonomike me qëllim përmirësimin e jetesës së familjeve të varfra në vend.


Mbrojtja sociale në Shqipëri përfshin: (1) përfitime sociale bazuar në sigurime; (2) përfitime të siguruara nëpërmjet ndihmës ekonomike si dhe (3) shërbime sociale për t'u ardhur në ndihmë grupeve të ndryshme të përjashtuara.

Mbrojtja sociale përmbledh të gjitha ndërhyrjet që sigurojnë: të ardhura ose transferta për të varfërit, mbrojtje të grupeve vulnerabël ndaj risqeve dhe synojnë të përmirësojnë respektimin e të drejtave dhe statusin social të individëve që janë pjesë e grupeve të marginalizuara. Objekti i saj është reduktimi i vulnerabilitetit ekonomik dhe social të të varfërve, grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara (devereux and Sabates-Wheeler, 2004)

Në vitin 2009, 1 në 5 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç jetonte në familje, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike (NE)¹⁴. Ky raport është edhe më problematik në qarkun e Kukësit, ku raporti është që 1 në 2 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç që jetonte në familje të trajtuara me NE. Nisur nga këto të dhëna, gjykojmë që qarku i Durrësit ka mirëqenien më të mirë të fëmijëve të kësaj grup-moshe, pasi ky raport është 1 në 53 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç, që jetojnë në familje të trajtuara me NE.


Në një analizë krahasuese ndërmjet qarqeve (ku operon aktualisht Observatori), shikojmë që qarku i Kukësit, ka përqindjen më të lartë të familjeve që trajtohen me NE dhe kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç në vlerën 29,35%. Qarku që e ka përqindjen më të ulët është qarku i Durrësit me vlerë 1%.

Familjet e varfëra me fëmijë 0-15 vjeç në nivel Qarku
Përqindjet, viti 2009



Qarku i Kukësit ka përqindjen më të lartë në nivel kombëtar të fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve u trajtuan me NE për vitin 2009 në vlerën 51,98% ose 11000 fëmijë. Në qarkun e Durrësit kjo përqindje ishte 50 herë më e vogël, duke pasur vetëm 1220 fëmijë (6-15 vjeç) që jetonin në familje të varfra ose 1,88%; Pra në këtë qark kishte me pak fëmijë që jetonin në familje të varfra.

Familjet (6-15) që jetojnë në familje të varfra
Përqindjet, viti 2009



¹⁴ Kjo shifër është nxjerrë nga zyra e observatorit, ku të dhënat bazë janë marrë nga drejtoritë përkatëse të shërbimit social në qark (të dhënat për numrin e familjeve me NE dhe fëmijë 6-15 vjeç). Numri i kësaj grup-moshe për vitin 2009 është marrë nga Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Tiranë.

Rrethet me përqindjen më të lartë të familjeve të varfra në Shqipëri me fëmijë 0-15 vjeç për vitin 2009, qenë:

- Rrethi i Peshkopisë me 22,59% (në qarkun e Dibrës),
- Rrethi Kukësit me 36,94% dhe rrethi i Hasit me 31,08% (në qarkun e Kukësit).

Komunat me përqindjen më të lartë të familjeve të varfra në Shqipëri për vitin 2009, janë:

- Komuna e Selishtës me 51,46% dhe komuna e Xibërit me 50,39% (qarku i Dibrës);
- Komuna e Surrojit me 64,01% dhe komuna e Ujmishtit me 50,18% (qarku i Kukësit).

Rrethi me numër më të lartë të fëmijëve (6-15 vjeç), të cilët jetojnë në familje të varfra, të krahasuara në nivel kombëtar, janë:


- Rrethi i Peshkopisë me 24,34% dhe rrethi i Bulqizës me 22,49% (qarku i Dibrës);
- Rrethi i Gramshit me 27,36% (qarku i Elbasanit);
- Rrethi i Pogradecit me 26,49% (qarku i Korçës);
- Rrethi i Kukësit me 63,18%, rrethi i Hasit me 45,9% dhe rrethi i Tropojës me 32,71% (qarku i Kukësit);
- Rrethi i Pukës me 47,7% (qarku i Shkodrës).

Familjet e varfra dhe fëmijët që jetojnë në familje të varfra në një nivel mbi 50% të raportit të popullatës, i gjejmë kryesisht në zona rurale malore, siç janë: komunat Selishtë, Ostren, Fushë-Çidhën, Melan, Sllovë (qarku i Dibrës); komunat Zapod-Orgjost, Fierzë, Topojan, Kukës (bashki), Tërthore, Bujan, Shtiçen, Malziu (qarku i Kukësit); komunat Iballë, Fushë-Arrëz, Fierzë, Hajmel, Shllak (qarku i Shkodrës).

Shënim: Shifrat e lartpërmendura janë përlogaritur bazuar vetëm në të dhënat zyrtare në nivel lokal dhe qendror që janë mbledhur nga zyra e Observatorit. Jashtë kësaj përlogaritjeje mbasin ato familje, të cilat janë të varfëra, por që nuk rezultojnë të regjistruara dhe, si rrjedhojë, nuk trajtohen me NE. Pra nuk janë përlogaritur ato familje që janë jashtë skemës së NE-ke


Nëse shikojmë raportin ndërmjet numrit të përgjithshëm të familjeve në nivel qarku dhe familjeve që trajtohen me NE dhe kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç, qarqet Shkodër, Elbasan, Korçë janë në një raport të drejtë; ndërsa qarqet Kukës dhe Dibër janë në një raport të zhdrejtë. Kjo do të thotë që, megjithëse nuk kanë një numër shumë të madh familjesh në nivel qarku, kanë të lartë numrin e familjeve që trajtohen me NE. Qarku i Durrësit, sipas të dhënave të Observatorit, del se ka në nivel të lartë mirëqenieje, ku raporti i numrit të familjeve që trajtohen me NE është i ulët në krahasim me numrin tërësor të familjeve të qarkut. Gjendja konkrete paraqitet në hartën më poshtë.

Harta 1. Raporti i familjeve me NE dhe fëmijë 0-15 vjeç kundrejt numrit të të gjitha familjeve në nivel qarku, viti 2009



Fëmijë të moshës 6-15 vjeç, përbëjnë pak a shumë të njëjtën përqindje, në krahasim me numrin e përgjithshëm të fëmijëve në nivel qarku (<18 vjeç), ku, p.sh.: Kukësi është 59%, Shkodra 58%, Durrësi 56%, Dibra 57%, Elbasani 57%, Korça 58%, Gjirokastra 57%, Vloja 58%. Ndërsa fëmijët 6-15 vjeç që jetojnë në familje të varfra, krahasuar me numrin e përgjithshëm <18 vjeç, përbëjnë një përqindje më të lartë për qarkun e Kukësit 31%.

Harta 2. Fëmijë të varfër në nivel qarku (6-15 vjeç)
Përqindje, 2009



Kapitulli 2


Qarku i Dibrës¹⁵



¹⁵ Specialiste e Observatorit për Qarkun Diber është Znj. Majlinda Hoxha.

2.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Dibrës numëroi 180 097¹⁶ banorë, prej të cilëve 33% i përkasin grup-moshës 0-18 vjeç, ose 60165¹⁷. Dibra, është një nga qarqet që paraqet shkallën më të lartë të fëmijëve dhe të rinjve (grup-mosha 0-18 vjeç) në krahasim me qarqet tjerë të vendit.



Për vitin 2009 kemi të dhëna për numrin e fëmijëve sipas njësive vendore. Kjo na jep mundësinë që gjatë analizës dhe krahasimit t'u referohemi numrit real të përfituesve apo numrit të fëmijëve që nuk gëzojnë të drejta specifike dhe zonat përkatëse.

Për të gjykuar për përfitimin nga e drejta për arsimim në Dibër (ashtu si në zonat e tjera të vendit) janë marrë për analizë dhe vlerësim tregues që lidhen kryesisht me aksesin ndaj shkollimit dhe aspekte të veçanta që lidhen me të.


Më poshtë po japim një informacion të detajuar lidhur me treguesit që pasqyrojnë numrin e nxënësve që përfitojnë nga e drejta për arsimin në qarkun e Dibrës sipas njësive vendore dhe nivelin e respektimit të saj. Gjithashtu, pjesë e këtij raporti është dhe pasqyrimi i realizimit të ndjekjes të shkollës në nivele të ndryshme.

2.2. E drejta për arsimim

2.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor (3-6 vjeç)

Numri i fëmijëve 3-6 vjeç në qarkun e Dibrës raportohet të jetë në vlerën 11427¹⁸ për vitin 2009, gjë e cila përbën 6,34% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 4. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Dibrës, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Regjistrimi i fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor, ndonëse janë hartuar politika nxitëse nga MASH, vazhdon të ketë shkallë të ulët të fëmijëve që duhet të përfitojnë nga edukimi parashkollor. Problematikë në qarkun e Dibrës, mbeten informacioni dhe mundësia e mbledhjes së të dhënave për këtë sistem. Siç shikohet dhe nga harta e mëposhtme, vetëm në ½ pjesë të territorit të qarkut është arritur që të mblidhet informacioni në lidhje me fëmijët që ndoqën arsimin parashkollor për vitin 2009, megjithëse ky informacion për vitin 2008 është

¹⁶ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.


¹⁷ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

¹⁸ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

me i plotë. Në këtë material mungojnë të dhënat për rrethin e Bulqizës, për arsye se stafi i angazhuar vitin e kaluar në këtë proces, tashmë punon në një institucion tjetër. Gjithsesi, të dhënat për rrethin e Bulqizës mungojnë në këtë trajtim. Ato po përgatiten nga ZA-ja e këtij rrethi dhe do të jenë pjesë e analizës krahasuese në raportin përfundimtar të projektit për periudhën 1-vjeçare në zbatim.

Duke analizuar komunat me të dhënat përkatëse, vëmë re që kryesisht ka një frekuentim më të lartë të këtij sistemi në qytetet dhe në rrethinat e tyre sesa në fshatra. Kështu, qyteti i Peshkopisë dhe komunat rreth saj, Tomin dhe Melan, kanë përkatësisht 53%, 46% dhe 54%. Gjithashtu, dhe qyteti i Burrelit dhe dy komuna rreth tij kanë një frekuentim prej 60% Burreli, Klosi 48% dhe Gurra 46%. Zonat problematike në regjistrimin e fëmijëve në parashkollor janë komunat Kastriot 22%, Lurë 20%, Sillovë 19%, Lis 19% dhe Arras 9%.

Harta 1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor, qarku i Dibrës, viti 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Dibrë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Duke analizuar shkallën e regjistrimit në arsimin parashkollor në nivel rrethi, Dibra ka një përqindje më të lartë (89%) në krahasim me Matin (74%).


Harta 2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor në nivel rrethi, qarku i Dibrës, viti 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Diber dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Njësitë vendore në qarkun e Dibrës tashmë kanë një prirje pozitive për hapjen e kopshteve për edukimin parashkollor. Nga vëzhgimet në terren, në përgjithësi del se çdo fshat ka një mjedis për realizimin e arsimit parashkollor, pavarësisht madhësisë së fshatit (numrit të familjeve dhe fëmijëve të kësaj grup-moshe). Por kushtet dhe hapësirat e këtyre mjediseve nuk arrijnë të përmbushin kërkesat e kësaj grup-moshe për të ndjekur arsimin parashkollor, duke bërë që këto mjedise ekzistuese të jenë të pamjaftueshme e të papërshtatshme për numrin e mundshëm të fëmijëve 3-6 vjeç që mund të ndjekin kopshtin¹⁹.

2.2.2. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar (6-15 vjeç)

Numri i fëmijëve 6-15 vjeç në qarkun e Dibrës raportohet të jetë në vlerën 34526²⁰ për vitin 2009, që përbën 11,17% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 5. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun e Dibrës, viti 2009

Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

¹⁹ Informacion i përcjellë nga eksperti i zyrës së Observatorit në Diber, Mars 2011


²⁰ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Pasqyra e të dhënave në lidhje me arsimin e detyruar paraqitet disi më e plotë, krahasuar kjo si me arsimin parashkollor, ashtu dhe me arsimin e mesëm. Megjithatë, nga 35 njësi vendore të qarkut të Dibrës (komuna dhe bashki), 9 prej tyre nuk kishin të dhëna (këto të dhëna, të cilat siç u tha më sipër, po përgatiten), nga të cilat 8 në Bulqizë dhe 1 komunë në rrethin e Matit (komuna e Ulzës).

Në analizë të komunave që kanë të dhënat përkatëse, gjejmë që nivelin më të lartë të regjistrimit e kanë qyteti i Burrelit dhe disa komuna përreth, si: Luznia 100%, Klosi 100%, Komsia 100%, Burreli 99%, Suçi 99% dhe Gurra 99%. Komunitet me një frekuentim më të ulët të arsimit të detyruar, ashtu dhe siç shikohet në hartën e mëposhtme, janë: Arrasi 78%, Lura 77%, Zall-Dardha 70%, Qendër-Tomini 70% dhe Melani 63%. Në ndryshim nga arsimi parashkollor, qyteti i Peshkopisë ka një frekuentim disi të ulët të arsimit të detyruar me 81%.

Paraqitja e tablove të tilla të situatave, do të jenë si instrument mbështetës për çdo individ, strukturë lokale (komunitet dhe bashkitë) për të patur një vlerësim konkret në terrenet e çdo komune, gjë e cila ndihmon në hartimin e analizave e më pas të pasqyruara në programe zhvillimi zonale.

Harta 3. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar, qarku i Dibrës, 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Diber dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendëshme.

2.2.3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm (përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç)

Numri i fëmijëve 15-18 vjeç në qarkun e Dibrës raportohet të jetë në vlerën 12345²¹ për vitin 2009, që e përbën 3,97% të popullatës së këtij qarku.


Grafiku 6. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Dibrës, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

Vjelja dhe analiza e këtij treguesi janë problematike, pasi informacionet me të dhëna u mundësuan në më pak se ½ e territorit të qarkut. Për ato komuna e bashki ku ky informacion ekziston, vëmë re që nivelin më të lartë të ndjekjes së arsimit të detyruar e kanë Burreli 100%, Bazi 100%, Lisi 100%, Q. Tomini 100%, Derjani 99%. Tej mase problematike paraqitet situata në komunën e Muhurrit 30%, të Zall-Dardhës 12% dhe të Lurës 9%.

Harta 4. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm, në nivel komune, qarku i Dibrës, 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Dibër dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

21 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Nëse do të analizojmë shkallën e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel rrethi, shikojmë që Rrethi i Dibrës, 89% ka një shkallë më të lartë frekuentimi se sa Rrethi i Matit, 74%.

Nga takimet me drejtues shkollash dhe përfaqësues të strukturave arsimore në qark informohemi që nivelet e këtij treguesi janë të mira. Kjo sepse në vlerat e këtyre treguesve nuk mund të përfshihen ato nxënës që nuk ndjekin arsimin e mesëm në shkollat e mesme të qarkut. Pra evidentohet se janë shumë fëmijë të kësaj grup-moshe (15-18 vjeç) që ndjekin arsimin e mesëm jashtë qarku të Dibrës. Ky numër i fëmijëve (informacion) nuk gjendet i pasqyruar në të dhënat që merren nga strukturat arsimore në qarkun e Dibrës²².

Harta 5. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm, qarku i Dibrës në nivel rrethi, viti 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Diber dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

2.3. Përshkrimi i situatës së fëmijëve romë dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Për vetë kushtet natyrore dhe largësinë nga qendrat urbane të vendit, në qarkun e Dibrës nuk ka popullsi rome me banim të përhershëm. Familje rome vijnë në Diber kryesisht gjatë verës dhe mungojnë në periudhat e tjera të vitit.

Duke qenë popullsi shtegtare, adresimi i politikave specifike për fëmijët romë ende nuk është parë me përparësi nga strukturat lokale në vend.

Situata është krejt ndryshe lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara. Nga të dhënat paraprahe dhe vëzhgimet e drejtpërdrejta del se qarku i Dibrës ka një numër të ndjeshëm të fëmijëve të këtij grupi, por edhe për ta, mungojnë të dhënat e plota (lidhur me treguesin moshe /frekuentim shkolle). Në vitet e fundit, përgjithësisht shihet një vëmendje e shtuar e strukturave lokale që

²² Informacion i përcjellë nga eksperti i zyrës së observatorit në Diber, mars 2011.

po punojnë për njohjen e plotë të situatës nëpërmjet treguesve që përdor zyra e Observatorit. Aktualisht DRShS-ja po punon për të vjelë dhe për të përcaktuar të dhënat statistikore që do të na japin informacion të plotë për këtë grup fëmijësh. Nisur nga puna që po bëhet, këto të dhëna do të jenë pjesë e analizës krahasuese dhe vlerësuese në raportin përfundimtar vjetor të projektit²³.

Për sa më sipër, duke përmbledhur problemet e vërejtura, mund t'i grupojmë ato në *çështje suksesi* dhe në *çështje kritike*, si më poshtë:

Disa nga sukseset e arritura nga zyra e Observatorit në Qark janë:

- Numri i madh i treguesve për të cilët kemi marrë informacion;
- Marrja e të dhënave deri në nivel komune;
- Janë shënuar fillesat e ndërtimit të sistemit të monitorimit, duke qene se të dhënat tashmë janë për 2 vite të njëpasnjëshme;
- Mund të bëhet vlerësim analitik dhe krahasues në drejtim vertikal (mes viteve në studim dhe viteve në të ardhmen), si dhe në drejtim horizontal (krahasim mes njësisve vendore, institucioneve etj.);
- Vlerësimet dhe propozimet e dala nga raporti janë jo vetëm në vija të përgjithshme, por edhe për tregues të veçantë dhe për njësi vendore të veçanta, sipas problematikave.

Çështje kritike, si:

- Pamundësia për të marrë informacione që lidhen me masën e investimeve, në përgjithësi, dhe për fëmijë, në veçanti, në fushën e arsimit dhe në fusha të tjera.
- Nuk ka të dhëna të detajuara lidhur me fëmijët me aftësi të veçanta (AK) në kopshte e shkolla, megjithëse ata përbëjnë një grup me numër të ndjeshëm fëmijësh në qarkun e Dibrës.
- Vështirësi për punën e veçantë me nxënësit me aftësi të kufizuara, përbën fakti se në zonat rurale të këtij qarku mbizotëron puna me klasa kolektive, sidomos në filllore dhe në klasat VI-IX. Pa dyshim që, në kushte të tilla, fëmijët me aftësi të kufizuara lihen disi jashtë vëmendjes.

2.4. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Dibrës ka një popullsi prej 180097²⁴ banorë dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 48209²⁵, nga të cilat 6206 ose 12,87% janë familje të varfra, të cilat kanë edhe fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç.

Në vitin 2009 në qarkun e Dibrës 1 në 5 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç jetonte në familje të trajtuara me ndihmë ekonomike.


Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike dhe kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç, është më e lartë në zonat rurale malore dhe kryesisht në komunat Selishtë 51,46%, Xibër 50,39%, Zall- Dardhë 43,33%, Arras 43,33%, Lurë 43,33% etj.

²³ Informacion i përcjellë nga eksperti i zyrës së observatorit në Dibër, mars 2011.

²⁴ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

²⁵ Burimi: DRShS, Qarku Dibrë

Harta 6. Përqindja e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, në komunën përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. DRShS në Qark.


Tabloja e përqindjes së fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, paraqitet problematike pothuajse në të njëjtat zona rurale malore të qarkut të Dibrës, siç ishte dhe për familjet me NE dhe që kanë fëmijë 0-15 vjeç. Komunat që kanë përqindjen më të lartë në këtë tregues, janë Selishta 78,38%, Ostreni 74,03%, Fushë-Çidhna 67,45%, Melani 56,63%, Sillova 54,17%, Lura 43,88%, Xibëri 40,09% dhe Muhurri 36,84%.

Tabela 1. Komunat me përqindjen më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.

Komunat	Përqindja e familjeve me NE dhe me fëmijë 0-15 vjeç
Selishtë	51,46%
Xibër	50,39%
Zall- Dardhë	43,33%
Arras	43,33%
Lurë	43,33%
Silovë	43,33%
Melan	43,33%
Kala e Dodës	43,33%

Burimi. DRShS në Qark.

Harta 7. Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, ndaj totalit të fëmijëve të kësaj grup-moshe në komunën përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Tabela 2. Komunitet me përqindjen më të lartë të fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve janë të varfra (që trajtohen me ndihmë ekonomike), për vitin 2009.


Komunitet	Përqindja e familjeve të varfëra (trajtohen me NE)
Selishtë	78.38
Ostren	74.03
Fushë- Çidhën	67.45
Melan	56.63
Silovë	54.17
Lurë	43.88
Xibër	40.09
Muhurr	36.84

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

2.5. E drejta për kujdes shëndetësor

2.5.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta në qarkun e Dibrës

Harta 8. Përqindja e fëmijëve (<18 vjeç) me nevoja të veçanta në nivel komune për qarkun e Dibrës, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.


Tabela 3. Komunat me përqindjen më të lartë të fëmijëve (<18 vjeç) me aftësi të veçanta, për vitin 2009.

Komunat	Përqindje
Koms	5,4
Suç	4,9
Zall -Dardhë	4,7
Ostren	4,5
Luzni	3,9
Derjan	3,9
Burrel	3,9
Fushë -Çidhën	3,6
Gurrë	3,6

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

2.5.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta për çdo rreth

Harta 9. Përqindja e fëmijëve (15-18 vjeç) me nevoja të veçanta në nivel rrethi për qarkun e Dibrës, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 4. Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve (15-18 vjeç) me aftësi të veçanta, për vitin 2009.


Komunat	Përqindje
Bulqizë	3,6
Dibër (rrethi)	3,2
Mat	2,4

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

2.5.3. Numri i konsultoreve për fëmijë në qarkun e Dibrës

Ashtu si dhe për problemet e tjera, edhe për shërbimin e konsultoreve, për qarkun e Dibrës kemi siguruar të dhëna vetëm për një pjesë të territorit. Nga pasqyrimi i gjendjes në hartë, shikohet që komunat që kanë dhe një shtrirje më të madhe territoriale, kanë një numër më të vogël të konsultoreve, ku përkatësisht janë: Lura me 6 dhe Selishta me 6, kjo pasi këto komuna kanë numër të vogël banorësh. Konkretisht, edhe në këto komuna, numri i konsultoreve për fëmijë, i parë në raport me numrin e fëmijëve del të jetë i një niveli të kënaqshëm, afërsisht 1 konsultore për 85-125 fëmijë. Kështu në komunën e Lurës ka 6 konsultore për 509²⁶ fëmijë gjithsej (<18 vjeç). Në komunën Selishtë janë 6 konsultore për 758²⁷ fëmijë të regjistruar (<18 vjeç).

Harta 10. Numri i konsultoreve për fëmijë në nivel komune për qarkun e Dibrës, për vitin 2009.



Burimi. DShP - Dibër, Tetor 2010.

Në komunën e Fushë-Çidhnës, që ka numrin më të vogël të konsultoreve për fëmijë (4), banojnë 1361²⁸ banorë, pra me një mesatare një konsultore për 340 banorë. Relievi malor në këtë zonë, dhe reshjet e borës (gjatë stinës së dimrit) e vështirësojnë punën e mjekëve, duke shtuar riskun për jetën për këta fëmijë të këtyre zonave. Komuna e Maqellarës që ka numrin më të lartë të konsultoreve për fëmijë, 22 konsultore, ka të regjistruar në territorin e saj 4536²⁹ fëmijë 0-18 vjeç, pra duke pasur një mesatare një konsultore për 206 fëmijë.

²⁶ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.


²⁷ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

²⁸ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

²⁹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Numri i konsultoreve për fëmijë në nivel komune, qarku i Dibrës, viti 2009

Grafiku 7. Paraqitja grafike e numrit të konsultoreve për fëmijë në nivel komune për qarkun e Dibrës. Në këtë grafik janë pasqyruar vetëm ato komuna për të cilat kemi të dhëna.



Burimi. DShP - Dibër, Tetor 2010.

2.5.4. Shkalla e imunizimit në qarkun e Dibrës sipas rretheve

Lidhur me imunizimin, për qarkun e Dibrës kemi vetëm të dhëna për rrethin e Dibrës, që paraqiten në hartën 12.

Harta 11. Shkalla e imunizimit në rrethin e Dibrës, për vitin 2009.



Tabela 5. Shkalla e imunizimit në rrethin e Dibrës, për vitin 2009.

Komunat	Përqindje
Dibër (rrethi)	99,7


Burimi. DShP, Dibër, janar 2011.

Burimi. DShP, Dibër, janar 2011.

2.5.5. Vdekshmëria foshnjore në qarkun e Dibrës në përqindje

Vdekshmëria foshnjore në nivel Qarku është përllogaritur bazuar në raportin e numrit të foshnjave që humbasin jetën, me numrin total të lindjeve për vitin 2009 në një komunë të caktuar. Për qarkun e Dibrës, komuna me vdekshmeri më të lartë foshnjore është komuna veriore Melan, me 38%.

Harta 12. Vdekshmëria foshnjore në nivel komune për qarkun e Dibrës, për vitin 2009.




Burimi: DShP, Dibër, janar 2011.

Tabela 6. Vdekshmëria foshnjore në nivel Komune për qarkun e Dibrës, për vitin 2009.

Komunat	Vdekshmëria foshnjore
Melan	38,4 %
Luzni	23,8 %
Muhurr	21,7 %
Arras	20 %
Peshkopi	17,1 %
Kala e Dodës	15,6 %
Maqellare	5,4 %
Fushë Cidhen	0 %
Kastriot	0 %
Lurë	0 %
Qendër- Tomin	0 %
Selishtë	0 %
Silovë	0 %
Zall-Dardhë	0 %
Zall- Rec	0 %

Burimi: DShP, Dibër, janar 2011.

Grafiku 8. Vdekshmëria foshnjore në nivel komune për qarkun e Dibrës, për vitin 2009.



Burimi. DShP, Dibër, janar 2011.

2.6. E drejta për pjesëmarrje

E drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve në jetën shoqërore dhe në vendimmarrje nuk ka pësuar ndryshime nga viti që kaloi. Nga informacionet e marra nëpër shkolla del se janë ngritur qeveritë e nxënësve (QN) në çdo shkollë. Por mungesa e traditës dhe shpesh e burimeve financiare bën që puna e QN-ve të jetë jo në nivelin e duhur. Gjithsesi, zgjedhja e tyre bëhet në përgjithësi me pjesëmarrjen e drejtë të vetë nxënësve.


Deri diku është krijuar njëfarë tradite e bashkëpunimit të tyre me komunat dhe kjo mbështetje shihet pozitive nga të dyja palët. Pavarësisht kësaj, fëmijët nuk marrin pjesë në zhvillimin lokal jo vetëm për problemet në komunitet, por as për çështje që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre. Por në Dibër ka disa OJF që punojnë për promovimin dhe njohjen e të drejtave të fëmijëve dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha aspektet e zhvillimit në komunitet.

Në këtë veprimtari dalin në pah disa **çështjet kritike**, si:

- Stafet e njësive vendore nuk kanë ndjeshmërinë e nevojshme ndaj problemeve të fëmijëve.
- Mungon tradita për të degjuar zërin e fëmijëve.
- Burimet financiare të pakëta kufizojnë pjesëmarrjen e nxënësve në vendimmarrjen në shkollë.

Kapitulli **3**


Qarku i Durrësit³⁰



³⁰ Specialiste e Observatorit për Qarkun Durrës është Znj. Izolta Canka.

3.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Durrësit numëronte 401348³¹ banorë, prej të cilëve 115 783 i përkasin grup-moshës 0-18 vjeç ose 29%³².




3.2. E drejta për arsim

3.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor (3-6 vjeç)

Numri i fëmijëve 3-6 vjeç në qarkun e Durrësit raportohet të jetë në 23468³³ për vitin 2009, shifër që përbën 13,52% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 9. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Durrësit, viti 2009




Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor, ende nuk kemi arritur të mbledhim të dhëna për qarkun e Durrësit. Në përgjithësi, në bashkitë Durrës, Shijak, Fushë-Krujë dhe Krujë po realizohet tërheqja e të gjithë fëmijëve 5-vjeçarë në klasat përgatitore. Kjo praktikë po gjen shtrirje edhe në shkollat e qendrave të komunave.

3.2.2. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar

Numri i fëmijëve 6-15 vjeç në qarkun e Durrësit raportohet të jetë në vlerën 65002³⁴ për vitin 2009, shifër që përbën 17,36% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 10. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun Durrës, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

³¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.


³² Burimi: Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

³³ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

³⁴ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar paraqet një tablo disi problematike në qarkun e Durrësit dhe rrethet e tij, ku rrethi i Durrësit është 67% dhe rrethi i Krujës rreth 2% më shumë, 69,4%.

Grafiku 11. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar në rreth, qarku Durrës, 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Durrës dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Në një statistikë të shkallës së regjistrimit në nivel komune për qarkun e Durrësit, vërejmë që komunat që kanë një regjistrim më të lartë janë Katundi i Ri (88,54%) dhe Fushë-Kruja (84,87%). Komunat që kanë një shkallë regjistrimi të ulët janë Maminasi (55,81%) dhe Gjepalaj (50,1%). Komuna me regjistrimin më të vogël të fëmijëve në arsimin e detyruar në qarkun e Durrësit është Bubqi me vetëm 6,69%.

Vështirësitë që zyrat lokale hasin në terren, ndihen të pranishme edhe në mungesën e të dhënave përkatëse. Po përmendim për qarkun e Durrësit disa nga organet vendore që nuk kanë të dhëna ose që nuk i bëjnë të njohura ato: komuna e Kodër-Thumanës, bashkia e Durrësit, komunat Xhafzotaj, Çudhi dhe Nikël.

Harta 13. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel komune, qarku i Durrësit, 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit në Tiranë, janar 2011

3.2.3. Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm (përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç)

Numri i fëmijëve 15-18 vjeç në qarkun e Durrësit në vitin 2009 ishte 22350³⁵, shifër që përbën 12,88% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 12. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Durrësit, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Zyra e Observatorit në Durrës nuk ka arritur të mbledhë të dhëna në lidhje me numrin e fëmijëve që ndjekin arsimin e detyruar.

Për sa i takon regjistrimit të fëmijëve në shkolla dhe vijueshmërisë së rregullt të mësimin nga ata, në qarkun e Durrësit veçohen disa *arritje dhe mangësi*. Ato mund t'i grupojmë si më poshtë:

Disa nga sukseset e arritura nga zyra e Observatorit në Qark janë:

- Përfshirja e strukturës së Observatorit në grupin e punës të ngritur nga bashkia e Durrësit për identifikimin e fëmijëve që lypin dhe largimin e tyre nga rruga.
- Ndërgjegjësimi i problematikave nëpërmjet veprimeve të ndryshme nga ana e Observatorit të Durrësit, si në rastin për hapjen e shkollës së mesme në zonën e Porto Romanos (protestë me fëmijët e zonës në kuadër të 1 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve).
- Bashkëpunimi me strukturat që merren me çështjet e fëmijëve dhe njohja nga këto institucione.
- Për sa i përket treguesit për numrin e fëmijëve me *nevoja të veçanta* në kopshtet dhe shkollat ku praktikohet mësimi i integruar, ka përmirësim në mbledhjen e të dhënave. Nga 13 komuna dhe bashki (pa përfshirë qytetin e Durrësit) 6 prej tyre kanë të dhëna për këtë tregues (të dhëna të cilat janë marrë nga administratorët socialë të komunave dhe të bashkive përkatëse), veprimtari kjo që po zgjerohet me plotësimin me të dhëna më të plota.

a. Çështje suksesi:

- Në sezonin veror janë organizuar kampe verore/shkolla verore për fëmijët romë dhe fëmijë të zonave periferike të qytetit.
- Është përmirësuar cilësia e mësimdhënies në ciklin 9-vjeçar dhe të mesëm si rezultat i zëvendësimit të mësuesve jashtë profilit me mësues të cilët kanë pasur arsimin përkatës.
- Kemi shtimin e numrit të mësuesve me arsim të lartë nga 88 në 108 në arsimin parashkollor, nga 213 edukatore gjithsej që ka Durrësi.

³⁵ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

b. Çështje kritike

- Numri i lartë i nxënësve nëpër klasa në qendrat urbane si në shkollat 9-vjeçare dhe në shkollat e mesme.
- Braktisja e shkollës, veçanërisht nga komuniteti rom dhe në zonat rurale me status ekonomik të ulët (veçanërisht gjatë ndjekjes së shkollës 9-vjeçare).
- Mungojnë të dhënat për fëmijët, të cilët nuk e kanë ndjekur fare arsimin e detyruar.
- Në fshatra mungojnë kopshtet me ushqim. Për sa i përket numrit të përgjithshëm të kopshteve nga viti 2008 deri në 2009, ai është i njëjtë, por numri i tyre në qytet është rritur me 4, ndërsa kemi uljen e numrit të kopshteve po në fshat me 4.
- Në disa nga kopshtet publike mungojnë kushtet e përshtatshme higjieno-sanitare (p.sh., kopshti në Shijak). Në Maminas, kopshti publik është mbyllur.
- Shkollat e mesme mungojnë në zonat periferike dhe në fshatra (p.sh., në zonën e Porto Romanos, te kënetat, zona e plazhit, në komunën Gjepalaj etj.).
- Në zonat ku nuk ka shkollë të mesme, nuk sigurohet transporti falas për fëmijët e varfër.
- Familjet e varfra, të cilat nuk kanë statusin e ndihmës ekonomike, nuk kanë përfituar nga skema e ri-mbursimit të teksteve shkollore për fëmijët e tyre që ndjekin arsimin e detyruar.
- Sipas të dhënave të marra nga administratorët socialë të komunave të qarkut të Durrësit (pa përfshirë qytetin) janë 124 fëmijë analfabetë mbi moshën 15 vjeç.


3.3. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Durrësit ka një popullsi prej 401348 banorë dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 102283, nga të cilat 1087 ose 1% janë familje të varfra dhe kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç.

Në vitin 2009 në qarkun e Durrësit kemi një situatë pozitive në lidhje me raportin e fëmijëve që jetojnë në familje të varfra, ku ky raport është 1 në 53 fëmijë të grup moshës 6-15 vjeç.

Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihme ekonomike që kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç në këtë qark, është e lartë në disa qendra vendore, përkatësisht në Çudhi 10,71%, Krujë (bashki) 4,26% dhe Shijak 3,93%, kjo në krahasim me komunat e bashkitë tjera të qarkut


Harta 14. Përqindja e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, në komunat përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. DRShS, Qarku Durrës

Tabloja e përqindjes së fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike është më e lartë në nivel me njësitë e tjera vendore të qarkut në të njëjtat zona ku dhe përqindja e familjeve me NE është e lartë, që janë përkatësisht: Çudhi 52.87%, Shijaku 7,83% dhe Kruja (bashkia) 4,97%.

Harta 15. Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, ndaj numrit tërësor të fëmijëve të kësaj grup-moshe në komunat përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Tabela 7. Komunat me përqindjen më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.

Komunat	% e familjeve me NE dhe fëmijëve 0-15 vjeç
Çudhi	10.71
Krujë (bashki)	4.26
Shijak	3.93
Fushë- Krujë	1.92
Nikël	1.15

Burimi. DRShS, Qarku Durrës

Tabela 8. Njësitë vendore me përqindjen më të lartë të fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve janë të varfëra (që trajtohen me ndihmë ekonomike), për vitin 2009.


Komunat	% e fëmijëve 6-15 vjeç me familje NE
Çudhi	52,87
Shijak	7,83
Krujë (bashki)	4,97
Fushë- Krujë	2,58
Gjepalaj	2,23

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

3.4. E drejta për kujdes shëndetësor

3.4.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta

Harta 16. Përqindja e fëmijëve (<18 vjeç) me nevoja të veçanta në nivel njësie vendore për qarkun e Durrësit, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.


Tabela 9. Njësitë vendore me përqindjen më të lartë të fëmijëve (<18 vjeç) me aftësi të veçanta, për vitin 2009.

Njësia vendore	Përqindja
Krujë (bashki)	2,3
Çudhi	1,9
Fushë- Krujë	1,8
Durrës (bashki)	1,5
Nikël	1,5
Shijak	1,4

Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

3.4.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në qark sipas rretheve

Harta 17. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel rrethi për qarkun e Durrësit, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.


Tabela 10. Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve 15-18 vjeç me aftësi të veçanta, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Krujë	1,5
Durrës (Rrethi)	1

Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Kapitulli 4

Qarku i Elbasanit³⁶




³⁶ Specialist i Observatorit për Qarkun Elbasan është Z. Artan Kruja.

4.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Elbasanit numëronte 420496³⁷ banorë, prej të cilëve 125633 i përkisnin grup-moshës 0-18 vjeç, ose 30%³⁸.

Qarku Elbasan




4.2. E drejta për arsim

4.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor (3-6 vjeç)

Në qarkun e Elbasanit grup-moshë 3-6 vjeç përbën 5,76% të popullatës ose 24204³⁹ fëmijë.


Grafiku 13. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Elbasan, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor për qarkun e Elbasanit, shikohet që ka një përfitim të ulët në më pak se 50%. Rrethi i Gramshit regjistron një shkallë më të lartë për qarkun për vitin 2009 (51,03%) dhe niveli më i ulët ndeshet në rrethin e Elbasanit me vlerë 34,15%.

Grafiku 14. Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor në nivel rrethi, qarku i Elbasanit, 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Elbasan dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

³⁷ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

³⁸ Burimi: Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

³⁹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Harta 18. Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor në nivel rrethi, qarku i Elbasanit, 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Elbasan dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

4.2.2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar

Në qarkun e Elbasanit, si në të gjitha qarqet e tjera, grup-mosha 6-15 vjeç përbën përqindjen më të lartë krahasuar me grup-moshat e tjera që përfshihen në ndjekjen e sistemit arsimor. Në qarkun e Elbasanit fëmijët 6-15 vjeç përbëjnë 13,78% të numrit të përgjithshëm të popullatës ose e shprehur në numër janë 71381⁴⁰ fëmijë.


Grafiku 15. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun e Elbasanit, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në qarkun e Elbasanit ka një përmirësim të ndjeshëm me shkallën e regjistrimit në arsimin parashkollor. Në nivel rrethi, Peqini paraqitet me 80,5% , ndërsa rrethi i Elbasanit me 11,6% më pak, në vlerën 68,89%.


⁴⁰ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 16. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar në rreth, qarku i Elbasanit, 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Dibër dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Në qarkun e Elbasanit nuk u arrit të mundësohet mbledhja e të dhënave për numrin e fëmijëve që ndjekin arsimin e detyruar për gati ½ pjesë të territorit. Megjithatë, nga të gjitha zonat për të cilat ne siguroam të dhëna për vitin 2009, situata paraqitet pozitive në këto komuna: Labinot-Mal 99,1%, Labinot-Fushë 93,82%, Papër 93,41%, Pajovë 93,13%, Kukur 87,87%, Shezë 81,12%.

Një ulje të frekuentimit të arsimit të detyruar shikohet kryesisht në komunat Grekan 63,37%, Gjegjan 57,47%, Kajan 57,35%, Belsh 56,87%, Gostimë 54,29%, Cërrik (bashki) 54,07%, Klos 43,07%, Fierzë 40,59%.


Harta 19. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel njësie vendore, qarku i Elbasanit, 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Dibër dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

4.2.3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm, përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç

Të rinjtë e moshës 15-18 vjeç përbëjnë 6% në qarkun e Elbasanit, krahasuar kjo me numrin e përgjithshëm të popullatës në qark për vitin 2009. Numri i të rinjve të kësaj grup-moshe në nivel qarku është 25233⁴¹.


Grafiku 17. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Elbasanit, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm paraqet të dhëna problematike për rrethin e Librazhdit me 53,64% dhe në Elbasan me 59,3%. Situata në Gramsh (65,42%) dhe në Peqin (61,12%), megjithëse në shifra problematike, është rreth 8% më e lartë.

Harta 20. Shkalla e regjistrimit në arsimin e mesëm në nivel rrethi, qarku i Elbasanit, 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Elbasan dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

4.3. Përshkrimi i situatës së fëmijëve romë dhe i fëmijëve me nevojë të veçanta

Gjatë këtij viti Këshilli i Qarkut të Elbasanit ka ngritur një grup pune teknik për çështjet e komunitetit rom. Ky grup përbëhet nga përfaqësues të bashkisë, të qarkut, të shoqërisë civile lokale, të drejtorive rajonale dhe të zyrës së Observatorit të Elbasanit. Nga ky grup teknik janë

⁴¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

marrë një sërë detyrash, masash paraprake dhe janë identifikuar një sërë problemesh, si vijon:

1. Si fillim është përzgjedhur si zonë pilot lagja "5 Maji" në Elbasan. Në këtë lagje do të vlerësohet problematika e komunitetit rom, si dhe është planifikuar që të punohet dhe për evidentimin e problematikave të këtij komuniteti. Deri tani është arritur që:
 - a) Të evidentohen vetëm në lagjen "5 Maji" 475 familje rome, në të cilat janë 118 fëmijë romë të përgjithshëm, shumica e tyre të lindur jashtë kufijve të Shqipërisë (kryesisht në Greqi). Këta fëmijë kanë ardhur në jetë nga prindër minorenë apo prindër të cilët edhe vete rezultojnë të përgjithshëm.
 - b) Të nxirren të dhëna për vijueshmërinë në institucionet arsimore. Nga to del se fëmijët e këtij komuniteti nuk arrijnë që të ndjekin arsimin parashkollor. Kjo ndodh për arsye pasi familjet e tyre nuk kanë mundësi për të paguar për shpenzimet mujore në kopsht. Në këtë pikë i është këshilluar drejtoria rajonale arsimore që të gjejë një zgjidhje të përshtatshme për ta.
 - c) Në lidhje me vazhdimin e shkollës, identifikohet që vetëm brenda semestrit të parë të vitit shkollor 2010-2011 e kanë braktisur shkollën 10 fëmijë romë. Këto fëmijë identifikohen si 'fëmijë të bankave të fundit' e janë më të stigmatizuarit e më të priturit për t'u dhunuar nga të tjerët.
 - ç) Niveli ekonomik tejet i ulët i familjeve rome, bën që këta fëmijë të jetojnë në kushte ekstremi varfërie dhe të një rrezikshmërie të lartë.
2. Grupi punoi për ngritjen e masave për të analizuar problematikat sociale, arsimore dhe ligjore. Kështu grupi gjatë punës së tij arriti që:
 - a) Të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të realizuar regjistrimin e 5 fëmijëve romë të përgjithshëm. Ndërkohë mbeten edhe 113 fëmijë të tjerë.
 - b) Të mundësojë organizimin e 3 takimeve me mësuesit e shkollave, të cilat frekuentohen dhe nga fëmijë të komunitetit rom. Gjithashtu, nga bashkia e Elbasanit janë realizuar dhe 34 takime me prindër dhe përfaqësues të komunitetit rom.
 - c) Të mundësojë hapjen e një klase nga projekti "Shansi i dytë" për 35 fëmijë në nevojë të këtij komuniteti.
3. Grupi i punës tashmë ka përgatitur një plan veprimi me veprimtari ndërgjegjëse, bazuar në problematikat e identifikuara në terren.
4. Grupi i punës po ndihmon gjithashtu dhe në përgatitjen e një plani veprimi, tashmë në nivel qarku për këta fëmijë.

Të gjithë hapat e ndërmarrë dhe nismat e lartpërmendura tregojnë një angazhim të strukturave lokale dhe të shoqërisë civile në qarkun e Elbasanit për të evidentuar dhe për të zgjidhur problemet e komunitetit rom, duke u përqendruar kryesisht në çështjet e fëmijëve. Megjithatë, nga puna e përditshme në terren, shikohet që janë dhe shumë probleme dhe nevoja të tjera për të ndërhyrë.

Fëmijët me nevoja të veçanta në qarkun e Elbasanit janë 3334, për të cilët situata mbetet gjithnjë shumë e vështirë, si pasojë e mungesës së shërbimeve.

Shërbimet shëndetësore dhe sociale për këta fëmijë vazhdojnë të jenë të njëjta, ku rol kryesor po luan shkolla speciale "Zëra jete", e cila mban edhe peshën kryesore në trajtimin e tyre. Po kështu, ndihmesë sporadike kanë dhënë edhe disa projekte.


4.4. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Elbasanit ka një popullsi prej 420496⁴² banorë dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 111967⁴³, nga të cilat 10291 ose 9,19% janë familje të varfra dhe kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç.

Në vitin 2009 në këtë qark 1 në 6 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç jetonte në familje, që trajtoheshin me ndihmë ekonomike (NE).

Në krahasim me njësitë e tjera vendore të qarkut, përqindja e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike, të cilat kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç në qarkun e Elbasanit, është e lartë veçanërisht në komunat Poroçan 40,87%, Orenjë 33,87%, Kukur 32,55% dhe Labinot-Mal 30,83%.

Harta 21. Përqindja e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, në komunën përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. DRShS, Qarku Elbasan

Tabela 11. Komunat me përqindjen më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.

Komunat	% e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike me fëmijë të moshës 0-15 vjeç
Poroçan	40,87
Orenjë	33,87
Kukur	32,55
Labinot- Mal	30,83
Zavalinë	27,51
Përrenjas	25,93
Stravaj	25,48
Lunik	22,22
Kodovjat	20,4
Qukës	19,64
Rrajcë	17,67
Gracen	17,49
Funar	16,94
Hotolisht	16,59
Klos	16,11


Burimi. DRShS, Qarku Elbasan

Në vazhdim po paraqesim përqindjen e fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike. Siç vërehet në tabelë 13 dhe në hartën e grafikun përkatës, kjo përqindje është më e lartë në rrethin e Gramshit (27,36%), në krahasim me rrethet e tjera të Elbasanit.

⁴² Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁴³ DRShS, Qarku Elbasan

Harta 22. Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, ndaj numrit të përgjithshëm të fëmijëve të kësaj grupmoshe në rrethet përkatëse, për vitin 2009.




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

4.5. E drejta për kujdes shëndetësor

4.5.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta

Harta 23. Përqindja e fëmijëve <18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel komune për qarkun e Elbasanit, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 12. Rrethet e Elbasanit me përqindjen përkatëse të fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, për vitin 2009.

Rrethi	Shkalla regjistrimit arsimi i mesem '09
Elbasan (rreth)	13,7
Gramsh	27,36
Librazhd	19,74
Peqin	12,65

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.


Tabela 13. Komunat me përqindjen më të lartë të fëmijëve <18 vjeç me aftësi të veçanta, për vitin 2009.

Komuna	Përqindja
Funar	4,2
Labinot- Mal	4,1
Shushicë	3,7
Kodovjat	3,6
Labinot- Fushë	3,2
Gramsh (bashki)	2,9
Qukës	2,5
Librazhd (bashki)	2,4
Kukur	2,3
Orenjë	2,3
Stravaj	2,2
Fierz	2,1
Gjinat	2,1
Qendër	2,1
Klos	2

Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

4.5.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në qark

Harta 24. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel rrethi për qarkun e Elbasanit, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 14. Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve 15-18 vjeç me aftësi të kufizuara, për vitin 2009.

Komunat	Përqindja
Funar	4,2
Labinot- Mal	4,1
Shushicë	3,7
Kodovjat	3,6
Labinot- Fushë	3,2
Gramsh (bashki)	2,9
Oukës	2,5
Librazhd (bashki)	2,4
Kukur	2,3
Orenjë	2,3
Stravaj	2,2
Fierz	2,1
Gjinar	2,1
Qendër	2,1
Klos	2

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

4.6. Raporti infermierë dhe mami për banorë në nivel komune

Ky raport është realizuar duke përdorur dy burime:


1. Drejtoria e Shëndetit Publik, (DSHP), e cila ka siguruar numrin e mjekëve, të infermierëve dhe të mamive në nivel qarku, por ka pasur raste që të dhënat janë marrë edhe nga zyra e statistikës së Prefekturës, për vitin 2009.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile Tiranë, e cila ka siguruar numrin e popullatës në nivel qarku për vitin 2009.

Raporti infermierë, mami apo mjekë për banorë, është përllogaritur duke pjesëtuar numrin e banorëve për punonjës shëndetësie, ku si rezultat kemi marrë sa banorëve u shërben një (1) mjek, infermier apo mami. Kjo u bë për arsye se në shumë zona nuk është e mundur të përllogariten nëse do të mbanim raportin mjekë, mami dhe infermierë për 100000 banorë, duke qenë se shumë komuna kanë një numër më të vogël se 100000 banorë.

Standardi kombëtar infermierë për banorë është 370 infermierë për 100000 banorë ose 1 (një) infermier për **270 banorë** (burimi: Ministria e Shëndetësisë, maj 2011). Standardi evropian në lidhje me raportin infermierë për banorë është 779 infermierë për 100000 banorë ose 1 (një) infermier për **128 banorë**.

Për qarkun e Elbasanit, raporti infermierë dhe mami për banorë në komunat e bashki (për ato zona që kemi siguruar të dhëna) është 1 (një) infermier për **233** banorë, ku standardi kombëtar është një infermier për 270 banorë.

Harta 25. Raporti infermierë dhe mami për banorë në nivel komune për qarkun e Elbasanit, për vitin 2009.




Burimi. DShP - Elbasan, Tetor 2010.

Numri i infermierëve dhe i mamive që janë në shërbim të banorëve në komunat e qarkut të Elbasanit, ka një shpërndarje të çrregullt për sa u përket zonave. Kështu, kemi njësi vendore, të cilat kanë një numër të lartë të infermierëve dhe të mamive për banorë, siç janë njësitë vendore (komuna e bashki): Cërrik, Gramsh (bashki), Kodovjat, Belsh, Peqin (bashki), Tunjë, Librazhd (bashki) dhe Përrenjas. Në këto njësi vendore numri i infermierëve dhe i mamive për banorë është *më i ulët* se standardi kombëtar, i cili është 1 (një) infermier për 270 banorë (ose 370 infermierë për 100000 banorë), si dhe me standardin evropian, i cili është 1 (një) infermier për 128 banorë (ose 779 infermierë për 100000 banorë)⁴⁴. Paraqitja grafike e mëposhtme tregon raportin e një infermieri për banorë.

⁴⁴ Burimi. Ministria e Shëndetësisë, maj 2011.

Raporti i 1 (një) infermjeri ose e 1 (një) mamie për banorë në nivel komune me numër më të lartë se standardi Qarku i Elbasanit, viti 2009

Grafiku 18. Paraqitja grafike e raportit infermierë dhe mami për banorë në nivel komune për qarkun e Elbasanit (në këtë grafik pasqyrohen komunat me një raport shumë të lartë deri tek një mesatare, pra komunat që kanë më pak infermierë dhe mami për banorë)




Burimi. DShP - Elbasan, Tetor 2010.

Komunat të cilat kanë një raport brenda standardeve kombëtare dhe evropiane, pra që kanë 1 infermier ose mami për më pak se 270 banorë, për qarkun e Elbasanit, janë: Labinot-Mal (1 infermier për 208 banorë), Tregan (1:202), Gjinar (1:189), Fierzë (1:183), Klos (1:176), Funar (1:173), Pishaj (1:165), Kukur (1:159), Stravaj (1:131), Cërrik (1:128) and Bashkia Gramsh (1:118), Kodovjat (1:110), Belsh (1:110), Bashkia Peqin (1:108), Tunje 1:93), Bashkia Librazhd (1:69), Prenjas (1:68).

4.6.1. Raporti mjek për banorë në nivel komune

Raporti mjek për banorë në komunat e qarkut të Elbasanit (për ato zona që kemi siguruar të dhëna), në nivel qarku është **3364** banorë për 1 (një) mjek, ku standardi kombëtar është një mjek për **546** banorë. Numri i mjekëve në komunë është shumë më i vogël, nëse do ta krahasonim atë dhe me numrin e infermierëve për banorë. Në raportin mjek/banorë nuk gjejmë ndonjë komunë që të jetë **afër apo brenda** standardeve kombëtare.

Harta 26. Raporti mjek për banorë në nivel komune për qarkun e Elbasanit, për vitin 2009.

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Numri i mjekëve që janë në shërbim të banorëve në të gjitha komunat e qarkut të Elbasanit, është larg standardit kombëtar, një mjek për 546 banorë. Më shumë problematike janë njësitë vendore (komuna apo bashki): Gostimë me një mjek për 12091, Qendër me 11037, Qukës me 10334, Shushicë me 10234, Rrajcë me 10145, Shirgjan me 9512, Papër me 8765, Pajovë me 8290, Mollas me 7510, Gjegjan me 7425 etj.

Në lidhje me numrin e doktorëve në shërbim të banorëve në Qarkun e Elbasanit, zonat më problematike dhe që janë larg standardit kombëtar (1 doktor për 546 banorë), janë: Gostimë (1:12,091), Qendër (1:11,037), Qukës (1:10,334), Shushicë (1:10,234), Rrajcë (1:10,145), Shirgjan (1:9,512), Papër (1:8,765), Pajovë (1:8,290), Mollas (1:7,510), Gjegjan (1:7,425), Bradashesh (1:7,416), Gjocaj (1:6,897), Hotolisht (1:6,778), Shales (1:6,693), Kajan (6,287), Labinot Fushë (1:6,171), Labinot Mal (1:5,405), Përparim (1:5,313), Orenje (1:5,229), Shezë (1:5,157), Grekan (1:4,912), Polis (1:4,902), Tregan (1:4,239), Klos (1:4,041).

4.6.2. Shkalla e imunizimit

Harta 27. Shkalla e imunizimit në rrethin e Elbasanit, për vitin 2009.



Burimi. DShP - Elbasan, janar 2011.

Tabela 15. Shkalla e imunizimit në rrethin e Elbasanit, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Elbasan (rreth)	99,92

Burimi. DShP - Elbasan, janar 2011.

4.7. E drejta për pjesëmarrje

Hapa pozitivë vazhdojnë të realizohen nga grupi "Zëri 16 +", i cili ka sjellë në Këshillin Bashkiak të Elbasanit zërin e fëmijëve, duke vetë analizuar nevojat e tyre e duke ndikuar për rritjen e fondeve për fëmijët.

Kjo nismë u përqafua edhe në hapa të mëtejshëm, duke bërë të mundshme që fëmijët të merrnin pjesë në procesin e diskutimit dhe të hartimit të projektbuxhetit që zhvillohet në periudhën shtator-nëntor të çdo viti, nga dalin përparësitë e komuniteteve të ndryshme nga takimet e bëra me çdo njësi administrative.

Kapitulli 5

Qarku i Gjirokastrës⁴⁵




⁴⁵ Specialiste e Observatorit për Qarkun Gjirokastrë është Znj. Eglantina Gjini.

5.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Gjirokastrës numëronte 156151⁴⁶ banorë, prej të cilëve 35816 ose 23% e tyre i përkisnin grup-moshës 0-18 vjeç⁴⁷.

Qarku Gjirokastrër




5.2. E drejta për arsim

5.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor (3-6 vjeç)

Në qarkun e Gjirokastrës në vitin 2009 ishin 6887⁴⁸ fëmijë të moshës 3-6, numër ky që përbën 3,36% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 20. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Gjirokastrës, viti 2009




Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor për qarkun e Gjirokastrës, gjendja është e pakënaqshme. Sipas të dhënave, ndjekja e kopshtit nga fëmijët e kësaj moshe është tepër e ulët. Konkreisht, si qark vetëm 50% e fëmijëve 3-6 vjeç janë të regjistruar në kopshte. Më keq paraqitet gjendja në rrethin e Gjirokastrës, ku vetëm 31,75% e fëmijëve shkojnë në kopsht dhe në rrethin e Tepelenës me 31,65%. Ndërsa në rrethin e Përmetit gjendja është disi më ndryshe. Në kopshte janë të regjistruar 68,78 % e fëmijëve 3-6 vjeç, gati 37% më shumë se në secilin nga dy rrethet e tjera.

⁴⁶ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁴⁷ Burimi: Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.


⁴⁸ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 21. Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor në nivel rrethi, për vitin 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Gjirokastrë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.


5.2.2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar

Në vitin 2009 në qarkun e Gjirokastrës ishin gjithsej 20515⁴⁹ fëmijë të moshës 6-16 vjeç, që duhej të ndiqnin klasat e arsimit të detyruar, numër ky që përbën 10,17% të popullatës së qarkut.

Grafiku 22. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun e Gjirokastrës, viti 2009


Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar në qarkun e Gjirokastrës ka një përmirësim në përgjithësi. Por arritja më e dukshme është në rrethin e Përmetit, ku ka një rritje prej rreth 30% në krahasim me nivelin e frekuentimit të sistemit parashkollor. Është për t'u vlerësuar fakti që Përmeti ka një shkallë regjistrimi të plotë në arsimin e detyruar, pra 100%, gjë që pasqyron dhe kulturën dhe dëshirën për arsimim të banorëve të kësaj zone.


Grafiku 23. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar sipas rretheve, viti 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Gjirokastrë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

⁴⁹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Harta 28. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel komune, viti 2009**5.2.3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm (përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç)**

Numri i fëmijëve 15-18 vjeç në qarkun e Gjirokastrës raportohet të jetë 2290⁵⁰ për vitin 2009, shifër kjo që përbën 3,61% të popullatës së qarkut.


Grafiku 24. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Gjirokastrës, viti 2009

Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

⁵⁰ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm në qarkun e Gjirokastrës pëson ulje në krahasim me arsimin e detyruar, duke synuar të ketë të njëjtën kurbë rritjeje. Rrethi i Përmetit ka një shkallë regjistrimi prej 83,44% , duke u pasuar nga Gjirokastra me 50,42% dhe Tepelena me 39,24%.

Grafiku 25. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm sipas rretheve, viti 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Gjirokastrë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Gjatë veprimtarisë së dy viteve të fundit, zyra e Observatorit në Gjirokastrë vëren se ka disa probleme që duhen zgjidhur. Si çështje kritike mund të shënojmë:

- Mungesën e bashkëpunimit institucional të DAR-së së Gjirokastrës me zyrën rajonale të Observatorit për të drejtat e fëmijëve;
- Mungesën e një database institucional për vitet shkollore 2008-2009 dhe 2009-2010 për shkak të ndërrimeve të shpeshta të punonjësve në zyrën e statistikave pranë DAR-së dhe në ZA-të;
- Problemet e hasura gjatë procesit të mbledhjes së treguesve në terren janë si pasojë:
 - E mos njësimit të të dhënave nga institucionet lokale, si dhe në shumë raste mos përpunimin e tyre kompjuterik. Kjo gjë pasqyrohet edhe në pasaktësinë e të dhënave të përcjella.
 - Nga vizitat në terren vihet re një ndarje e shkollave apo e klasave ku mësojnë fëmijët e komunitetit rom. Nuk ka një integrim të nxënësve romë në të gjitha shkollat e qytetit të Gjirokastrës.


5.3. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Gjirokastrës ka një popullsi prej 156151⁵¹ banorë dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 23005⁵². Vetëm në rrethin Gjirokastrë, kemi 139 familje të varfra që kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç, që përbëjnë vetëm 0,62%; në rrethin e Përmetit këto familje përbëjnë 5,72%.

⁵¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁵² RSSD, Gjirokastrë Region – 2010.

Harta 29. Përqindja e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, në rrethet përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. RSSD, Qarku
Gjirokastrë – 2010.

Tabela 16. Rrethet e Gjirokastrës me përqindjet përkatëse të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe kanë fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.


Rrethi	Përqindje
Përmet	5,75
Gjirokastrë (rreth)	0,62

Burimi. RSSD, Qarku
Gjirokastrë – 2010.

5.4. E drejta për kujdes shëndetësor

5.4.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta

Harta 30. Përqindja e fëmijëve <18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel komune për qarkun e Gjirokastrës, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSShB,
Shërbimi Social
Shtetëror, prill 2011.

Tabela 17. Komunitat me përqindjen më të lartë të fëmijëve <18 vjeç me aftësi të veçanta, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindje
Tepelenë (bashki)	2,3
Ballaban	2,1
Qendër	1,9
Përmet (bashki)	1,6
Sukë	1,6
Fshat Memaliaj	1,6
Memaliaj	1,5
Luftinjë	1,4
Çarçovë	1,2
Krahës	1,2
Cepo	1

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi
Social Shtetëror, prill 2011.

5.4.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta sipas rretheve

Harta 31. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel rrethi për qarkun e Gjirokastrës, për vitin 2009.




Tabela 18. Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve 15-18 vjeç me aftësi të kufizuara, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindje
Tepelenë	2,5
Përmet	1,9
Gjirokastrë (rreth)	0,5


Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

5.4.3. Raporti infermierë dhe mami për banorë në nivel komune, qarku i Gjirokastrës

Raporti infermierë dhe mami për banorë në komunat e qarkut të Gjirokastrës (për ato zona që kemi siguruar të dhëna), nuk është në parametrat e duhur. Në nivel qarku shërben 1 (një) infermier për **387** banorë, kur standardi kombëtar është një infermier për 270 banorë.

Harta 32. Raporti infermierë dhe mami për banorë në nivel komune për qarkun e Gjirokastrës, për vitin 2009.



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.


Njësitë vendore, të cilat kanë një raport larg standardeve kombëtare dhe evropiane, pra që kanë 1 infermier ose mami për më shumë se 270 banorë, janë: komuna e Dropullit të Sipërm (1 infermier për 847 banorë), Bashkia Gjirokastrë (1:797), Lazarati (1: 677), Bashkia Memaliaj (1: 665), Pogoni (1:656), Bashkia Përmet (1:654), Dropulli i Poshtëm (1:574), Lunxhëria (1:415), Libohova (1:347), Çarçova (1:314), Cepoja (1:300), Bashkia Tepelenë (1:299). Paraqitja grafike e mëposhtme tregon raportin e një infermieri për banorë të këtyre zonave:

Njësitë vendore që kanë një raport **brenda** standardeve kombëtare dhe evropiane, pra që kanë 1 infermier ose mami **për më pak** se 270 banorë, janë: Qendër (1:262), Petran (1:255), Dishnicë (1:230), Krahes (1:222), Qendër-Piskovë (1:219), Këlcyrë (1:201), Sukë (1:187), Luftinjë (1:170), Ballaban (1:143). Paraqitja grafike e mëposhtme tregon raportin e një infermieri për banorë të këtyre zonave:

5.4.4. Raporti mjek për banorë në nivel njësie vendore, qarku i Gjirokastrës

Raporti mjek për banorë në njësitë vendore të qarkut të Gjirokastrës (për ato zona që kemi siguruar të dhëna), është 1 (një) mjek për **2692** banorë, ku standardi kombëtar është një mjek për **546** banorë. Numri i mjekëve në komuna është shumë më i vogël, nëse do ta krahasonim atë dhe me numrin e infermierëve për banorë. Në raportin mjek/banorë nuk gjejmë ndonjë komunë që të jetë **afër apo brenda** standardeve kombëtare në këtë qark.

Harta 33. Raporti mjek për banorë në nivel njësie vendore për qarkun e Gjirokastrës, për vitin 2009.




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Numri i mjekëve që janë në shërbim të banorëve, pa përjashtim në të gjitha komunat e qarkut të Gjirokastrës, është larg standardit kombëtar që është një mjek për 546 banorë. Njësitë vendore (komunat dhe bashkitë) shumë problematike, janë: Dropull i Sipërm (1:5,507), Këlcyra (1:4,825), Bashkia Gjirokastrë (1:3,720), Lazarat (1:3,386), Cepojë (1:3,304), Pogon (1:3,282), Dropull i Poshtëm (1:3,250), Çarçovë (1:3,139), Petran (1:3,060), Luftinjë (1:2,812), Qendër (1:2,791), Sukë (1:2,615). Fshat Memaliaj (1:2,270), Krahës (1:2,220), Qendër Piskovë (1:2,192), Lunxhëri (1:2,177), Bashkia Permet (1:2,092), Bashkia Tepelenë (1:2,090), Memaliaj (1:1,830), Libohovë (1:1,824), Dishnicë (1:1,378) dhe Ballaban (1:1,142).

5.4.5. Shkalla e imunizimit

Harta 34. Shkalla e imunizimit në secilin rreth të qarkut të Gjirokastrës, për vitin 2009.



Burimi. DShP e Gjirokastrës, janar 2011.


Tabela 19. Shkalla e imunizimit sipas rretheve në qarkun e Gjirokastrës, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindje
Gjirokastër (rrethi)	99,84
Përmet	99,89
Tepelenë	98,8

Burimi. DShP e Gjirokastrës, janar 2011.

Kapitulli 6


Qarku i Korçës⁵³



⁵³ Specialiste e Observatorit për Qarkun Korçë është Znj. Marjana Jorgji.

6.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Korçës numëronte 349748⁵⁴ banorë, prej të cilëve 88219 i përkasin grup-moshës 0-18, ose 25%⁵⁵.




6.2. E drejta për arsim

6.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor (grup-mosha 3-6 vjeç)

Numri i fëmijëve 3-6 vjeç në qarkun e Korçës ishte 17333⁵⁶ për vitin 2009, shifër që përbën 5,46% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 26. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Korçës, viti 2009




Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor për qarkun e Korçës ishte problem mbledhja e të dhënave, pasi ato thuajse mungonin tërësisht. Duke u bazuar vetëm në ato të dhëna që kemi arritur të mbledhim për këtë qark, shikojmë që shkalla më e lartë e regjistrimit në parashkollor nuk e kalon 50%. Kështu, Devolli ka të regjistruar 47,29% të fëmijëve 3-6 vjeç në kopshte, Kolonja 32,89%, ndërsa për Pogradecin nuk është mundur të sigurohet asnjë e dhënë.

⁵⁴ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁵⁵ Burimi: Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.


⁵⁶ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 27. Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor në secilin rreth, qarku i Korçës, viti 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Korçë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

6.2.2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar (grup-mosha 6-15 vjeç)

Sipas raportimeve, numri i fëmijëve të grup-moshës 6-15 vjeç në qarkun e Korçës për vitin 2009 ishte 50845⁵⁷ fëmijë, shifër kjo që përbën 15,40 % të popullatës së këtij qarku.


Grafiku 28. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun e Korçës, viti 2009

Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar në qarkun e Korçës, nga të dhënat që ka mbledhur zyra e Observatorit, shfaqet problematike me një përqindje të ulët. Koncretisht, rrethi i Devollit është 68,95%, rrethi i Pogradecit 63,27% dhe rrethi i Kolonjës 51,26%. Të dhënat nga rrethi i Korçës mungojnë.

⁵⁷ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 29. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar sipas rretheve, qarku i Korçës, viti 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Korçë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Siç shikohet dhe nga harta e Korçës (në nivel komune dhe bashkie) nga më shumë se ½ e territorit mungojnë të dhënat. Megjithatë, ndër zonat që kanë një shkallë të lartë regjistrimi, janë: Trebinja 96,54%, Bilishti 86,8%, Progër 77,66%, Buçimas 75%, Erseka 73,56%.

Një shkallë e ulët regjistrimi vihet re kryesisht në zonën e Pogradecit, në bashkinë e Leskovikut me 42,13%, në Mollas 38,12% dhe në Qendër-Ersekë 37,4%.

Harta 35. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel njësie vendore, qarku i Korçës, viti 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Korçë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

6.2.3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm (përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç)

Numri i fëmijëve 15-18 vjeç në qarkun e Korçës raportohet të jetë 16900⁵⁸ për vitin 2009, shifër që përbën 5,10% të popullatës së këtij qarku.


Grafiku 30. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Korçës, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm në qarkun e Korçës pëson ulje në krahasim me arsimin e detyruar me 10%-15%, bazuar në krahasimin e grafikut për arsimin e detyruar me grafikun për arsimin e mesëm. Shkalla e regjistrimit në këtë rajon identifikohet të jetë rreth 50%, ku janë vlerat e mëposhtme: Kolonja 55,46%, Pogradeci 54,74%, Devolli 49,8%.

Grafiku 31. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm në rrethe, qarku i Korçës, viti 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Korçë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

6.2.4. Arritje e çështje suksesi

Gjatë veprimtarisë së zyrës së Observatorit në Korçë kanë dalë edhe disa probleme e shqetësime, të cilat po i grupojmë në çështje suksesi dhe në çështje kritike.

Disa nga sukseset e arritura nga zyra e Observatorit në Qark janë:

- Tashmë zyra e Observatorit ka arritur të grumbullojë të dhëna deri në nivel komune, ndryshe nga një vit më parë.
- Gjatë këtij viti të dytë të projektit janë vendosur kontakte dhe me disa nga drejtuesit e shkollave në nivel komune.
- Tashmë në Korçë është ngritur dhe një projekt pilot në një shkollë 9-vjeçare, ku realizohet mësimi i gjuhës rome.

Çështje kritike, si:

- Nga vëzhgimet në terren identifikohet që braktisja e shkollës vazhdon të jetë e lartë në bashkinë e Korçës;
- Një problem i identifikuar nga bashkëpunimet me institucionet vendore është mos përgjigjja në kohë e tyre ndaj interesit dhe kërkesave që ne u dërgojmë në lidhje me treguesit përkatës.
- Vazhdojmë të ndeshim në terren praninë dhe funksionimin e klasave kolektive, si një çështje e hasur dhe një vit më parë.

6.2.5. Një rast pozitiv nga puna monitoruese në terren - Observatori i Korçës⁵⁹

Në shkollën 9-vjeçare "Naim Frashëri" të qytetit të Korçës, ndjekin mësimet 349 fëmijë (nga të cilët 148 janë vajza). E veçanta e kësaj shkolle është se mbi 90% e nxënësve të saj i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. Themi rreth 90%, pasi kur janë intervistuar fëmijët e kësaj shkolle në lidhje me etninë e tyre, shumica nuk e identifikojnë se kujt etniteti/komuniteti i përkasin.



Foto nga shkolla 9-vjeçare "Naim Frashëri", janar 2011, Korçë.

Përfaqësuesi i shoqatës rome në Korçë, z. Arben Kosturi, është një nga veprimtarët më të njohur në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të këtij komuniteti. Që nga fillimi i këtij viti shkollor (shtator 2010), z. Arben Kosturi zhvillon disa orë mësim në javë pranë kësaj shkolle për mësimin e gjuhës, të kulturës dhe të traditave rome. Kjo është një nismë e mbështetur dhe nga DAR-i i Korçës me mbështetjen e qeverisë zvicerane. Këto orë ekstra-kurrikulare mësimi përdoren njëkohësisht edhe për të komunikuar drejtpërdrejt me prindërit e fëmijëve romë, për të theksuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e ndjekjes së mësimin në shkollë.

6.3. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Korçës ka një popullsi prej 349748⁶⁰ banorë dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 102177⁶¹, nga të cilat 7512 ose 7,35% janë familje të varfra dhe kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç.

Në vitin 2009 në qarkun e Korçës raportohet që 1 në 8 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç jetonte në familje të cilat trajtohej me ndihmë ekonomike.


⁵⁹ Informacioni është përcjellë nga koordinatoresha e zyrës së observatorit në Korçë, znj. Marjana Jorgji, më 29 janar 2011.

⁶⁰ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁶¹ DRSHS, Qarku Korçë.

Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike dhe kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç, në qarkun e Korçës, paraqitet më e lartë në rrethin e Pogradecit, në krahasim me rrethet e tjera të qarkut, me 16,48%.

Harta 36. Përqindja e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, në rrethet përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. DRShS, Qarku Korçë.

Tabela 20. Rrethet e Korçës me përqindjet përkatëse të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe kanë fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Pogradec	16,48
Korçë (rrethi)	4,45
Kolonjë	5,04
Devoll	1,93

Burimi. DRShS, Qarku Korçë.

Tabloja e përqindjes së fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike është përsëri më e lartë në rrethin e Pogradecit me vlerë 26,49% në krahasim me rrethet e tjera të Korçës, të cilat e kanë përkatësisht tepër më të ulët. Konkretisht, Devolli 3,75%, Kolonja 7,83% dhe Korça 8,33%.

Harta 37. Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, ndaj totalit të fëmijëve të kësaj grup-moshe në rrethet përkatëse, për vitin 2009.




Tabela 21. Rrethet e qarkut të Korçës me përqindjet përkatëse të fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve janë të varfra dhe trajtohen me ndihmë ekonomike, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Pogradec	26,49
Korçë (rreth)	8,33
Kolonjë	7,82
Devoll	3,75


Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

6.4. E drejta për kujdes shëndetësor

6.4.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta

Harta 38. Përqindja e fëmijëve <18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel komune për qarkun e Korçës, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 22. Komunat me përqindjen më të lartë të fëmijëve <18 vjeç me aftësi të kufizuara, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Trebinjë	3,5
Propisht	3,3
Qendër -Ersekë	3,2
Vreshtas	2,9
Mollas	2,6
Ersekë	2,3
Gorë	2
Leskovik (Bashki)	1,9
Hudënisht	1,8
Pirg	1,7
Pojan	1,7
Voskopojë	1,6

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

6.4.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta sipas rretheve në qark

Harta 39. Përqindja e fëmijëve të grup-moshës 15-18 vjeç me aftësi të kufizuara në nivel rrethi për qarkun e Korçës, për vitin 2009.




Tabela 23. Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve të grup-moshës 15-18 vjeç me aftësi të kufizuara, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Pogradec	2,7
Kolonjë	2
Devoll	1,6
Korçë (rrethi)	0,9


Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

6.4.3. Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në nivel komune, qarku i Korçës

Raporti infermierë dhe mami për banorë në komunat e qarkut të Korçës (për ato zona që kemi arritur të sigurojmë të dhëna), paraqitet në jetë shumë larg standardit kombëtar. Kështu, raporti infermierë për banorë në nivel qarku është 1 (një) infermier për **1642** banorë, kur standardi kombëtar është një infermier për 270 banorë.

Harta 40. Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në nivel komune për qarkun e Korçës, për vitin 2009.




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Në të gjitha komunat e qarkut të Korçës, shikojmë që **ka mungesa të** theksuara të shërbimit mjekësor në këto zona, ku asnjëra komunë nuk arrin të jetë afër apo brenda standardit Kombëtar. Kështu, përmendim: komuna e **Liçenasit** ka një infermier për **5273** banorë, komuna e **Drenovës** ka një infermier për **3568** banorë, komuna e **Vrështasit** ka një infermier për **3399** banorë, komuna e **Libonikut** ka një infermier për **3388** banorë, komuna e **Progërit** ka një infermier për **3014** banorë, komuna e **Qendrës** ka një infermier për **2746** banorë, komuna e **Mirasit** ka një infermier për **2682** banorë etj. Paraqitja grafike e mëposhtme tregon raportin e një infermieri për banorë të këtyre zonave:

**Raporti i 1 (një) infermier ose mami për banorë në nivel komune
me numër më të lartë se standardi
Qarku i Korçës, viti 2009**


Grafiku 32. Paraqitja grafike e raportit të 1 (një) infermieri ose e mamie për banorë në nivel komune për qarkun e Korçës (në këtë grafik pasqyrohen komunat me një raport më të ulët se standardi, (pra komunat që kanë më pak infermierë dhe mami për banorë).



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

6.4.4. Raporti mjek për banorë në nivel komune, qarku i Korçës

Raporti mjek për banorë në komunat e qarkut të Korçës (për ato zona që kemi mundur të sigurojmë të dhëna) në nivel qarku është 1 (një) mjek për **2777** banorë, kur standardi kombëtar është një mjek **546** për banorë. Numri i mjekëve në komuna është shumë më i vogël, nëse do ta krahasonim atë dhe me numrin e infermierëve për banorë. Në raportin mjek/banorë nuk gjejmë ndonjë komunë që të jetë **afër apo brenda** standardeve kombëtare në këtë qark.


Harta 41. Raporti një mjek për banorë në nivel komune për qarkun e Korçës, për vitin 2009.

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Numri i mjekëve që janë në shërbim të banorëve në të gjitha komunat e qarkut të Korçës, është tepër larg standardit kombëtar, një mjek për 546 banorë. Njësitë vendore më shumë problematike janë Bashkia Pogradec (1:3,851), Ersekë (1:3,626), Hoçisht (1:3,600), Vreshtas (1:3,399), Bashkia Korçë (1:3,334), Voskopojë (1:3,029), Qendër-Bilisht (1:2,976), Qendër (1:2,746), Libonik (1:2,710), Miras (1:2,682), Maliq (1:2,651), Liqenas (1:2,625), Gore (1:2,637), Bilisht (1:2,468), Hudenisht (1:2,434), Pojan (1:2,431), Çerrave (1:2,404), Qender (1:2,371), Buçimas (1:2,362), Pirg (1:2,362), Mollaj (1:2,300), Leskovik (1:2,203), Propisht (1:2,193), Drenovë (1:2,141), Mollas (1:2,096), Proger (1:2,009), Velçan (1:1,820), Voskopojë (1:1,741), Dardhas (1:1,673), Trabinje (1:1,618).

6.4.5. Shkalla e imunizimit

Harta 42. Shkalla e imunizimit në qarkun e Korçës në nivel rrethi, për vitin 2009.



Burimi. DShP, Korçë, janar 2011.

Tabela 24. Shkalla e imunizimit në qarkun e Korçës në nivel rrethi, për vitin 2009.


Rrethi	Përqindja
Pogradec	2,7
Kolonjë	2
Devoll	1,6
Korçë (rrethi)	0,9

Burimi. DShP, Korçë, janar 2011.

6.4.6. Vdekshmëria foshnjore për qarkun e Korçës

Treguesi i "Vdekshmërisë Foshnjore" është marrë nga DSHP Korçë e përlogaritur si 'vdekje për 1000 lindje të gjalla'. Të dhënat përkatëse për këtë tregues, pasqyrohen si më poshtë për tre rrethet e Qarkut Korçë.

Harta 43. Vdekshmëria foshnjore në nivel rrethi për qarkun e Korçës për vitin 2009.



Burimi. DShP, Korçë, janar 2011.

Tabela 25. Vdekshmëria foshnjore në nivel rrethi për qarkun e Korçës për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Korçë (rrethi)	10
Pogradec	3
Devoll	2
Kolonjë	1


Burimi. DShP, Korçë, janar 2011.

6.5. E drejta për pjesëmarrje

Për sa i përket vendimmarrjes së fëmijëve, përgjithësisht mungon zëri i fëmijëve në procese vendimmarrëse: në shkollë, nivele qeverisjeje lokale apo në komunitete. Pozitive në këtë fushë është nisma e shoqërisë civile për sa i përket veprimtarisë së qeverive të nxënësve. Njëkohësisht, në gjimnaze janë ngritur e funksionojnë parlamentet rinore, të cilat kanë ndonjë të drejtë vendimmarrëse në çështjet e shkollës, por kjo nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu, parlamenti rinor është përfaqësuar edhe në parlamentin qendror. Por këto organizma janë vetëm në gjimnazet e qyteteve, ndërsa në shkollat e mesme në fshatra ende nuk funksionon një organizim i tillë.

Kapitulli 7

Qarku i Kukësit⁶²




⁶² Specialist i Observatorit për Qarkun Kukës është Z. Shkëlqim Muça.

7.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Kukësit numëronte 106923⁶³ banorë, prej të cilëve 35732 i përkisnin grup-moshës 0-18 ose 33%²⁵, duke qenë kështu qarku me përqindjen më të lartë të popullsisë 0-18 vjeç në krahasim me qarqet e tjera.

Qarku Kukës




7.2. E drejta për arsim

7.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor të fëmijëve 3-6 vjeç

Përqindja e grup-moshës parashkollore në qarkun e Kukësit (3-6 vjeç) është në vlerën 6,26% të popullatës ose 5193⁶⁴ fëmijë.

Grafiku 33. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Kukësit, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor për qarkun e Kukësit, nga tri rrethet që ka ky qark, vetëm për dy prej tyre kemi të dhëna, pikërisht për Kukësin dhe Tropojën. Të dhënat për rrethin e Hasit mungojnë.

Niveli i regjistrimit në parashkollor në të dyja rrethet, që kemi të dhëna, paraqitet i ulët, rrethi i Kukësit me 50,65% dhe rrethi i Tropojës me 27,06%. Rrethi i Tropojës ka rreth 23% më pak fëmijë të regjistruar në nivelin më të ulët të regjistrimit në arsimin parashkollor, në krahasim me rrethin e Kukësit.

Një dukuri e tillë shpjegohet edhe me kushtet e mjedisit, pasi shtrirja dhe shpërndarja gjeografike e fshatrave të rrethit të Tropojës është më e madhe. Ka fshatra që janë mbi 5 km larg objekteve shkollore. Ka raste që nxënësve u duhet të bëjnë 1-2 orë rrugë për të shkuar nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas. Me gjithë investimet e bëra për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, ende ka probleme të cilat vështirësojnë përmirësimin e cilësisë së edukimit të fëmijëve. Godinat shkollore, përgjithësisht, janë të amortizuara dhe larg standardeve që ka

⁶³ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁶⁴ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.


përcaktuar shteti ynë. 90% e tyre nuk kanë kushte higjieno-sanitare përshtatur standardeve për djem e për vajza, uji i pijshëm mungon në më shumë se 50 % të shkollave, më shumë se 40% e shkollave nuk kanë rrjet elektrik, shkollat e fshatit nuk kanë linjë telefonike.

Si qark, financimi i shkollave vazhdon të mbetet në nivele të ulëta. Mungon transparenca e fondeve në shërbim të arsimit. Komuniteti shkollor dhe bordet e shkollave nuk kanë në dispozicion fondin për çdo shkollë.

Pjesa mbizotëruese e shpenzimeve shkon për pagat e personelit mësimor. Transferta e pakushtëzuar, e cila do të mund të lehtësonte kushtet e të nxëniet, është në nivele të ulëta. Po aq në nivele të ulëta janë paratë që shkollat përfitojnë prej burimeve të brendshme të bashkive e të komunave.

Fondet e pamjaftueshme që niveli lokal u veçon shkollave ndikojnë në uljen e cilësisë të mirëmbajtjes së godinave shkollore dhe mosrespektim të normave të konsumit të pajisjeve shkollore dhe të mjeteve mësimore, por, ndërsa në disa zona të tjera, prindërit shtrëngohen të mbushin disi nevojat financiare të shkollave, në qarkun e Kukësit ky kontribut është kaq i vogël sa nuk sjell ndonjë ndryshim në kushtet e të nxëniet⁶⁵.

Grafiku 34. Shkalla e regjistrimit në arsimin e parashkollor në nivel rrethi, qarku i Kukësit, viti 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Kukës dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

7.2.2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar (fëmijët 6-15 vjeç)

Fëmijët në moshën shkollore përbëjnë një përqindje më të lartë se fëmijët në parashkollor dhe ata që ndjekin shkollën e mesme. Një arsye e evidente është se kjo grup-moshë (6-15 vjeç) ka një segment më të madh vitesh. Përqindja e grup-moshës 6-15 vjeç është 19,79 % krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullatës në qarkun e Kukësit ose në numër është 21164⁶⁶ fëmijë.

Grafiku 35. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun e Kukësit, viti 2009




Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

⁶⁵ Informacion i sjellë nga eksperti i observatorit në Kukës, Shkelqim Muça.

⁶⁶ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar në qarkun e Kukësit, sipas rretheve, është në nivel më të lartë krahasuar me qarqet e tjera. Rrethet kanë përkatësisht këtë shkallë regjistrimi: Kukësi 80,8%, Hasi 80,25%, Tropoja 78,1%.

Grafiku 36. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar sipas rretheve, qarku i Kukësit, viti 2009




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Kukës dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Në Qarkun e Kukësit të dhënat në nivel Komune janë mbledhur kryesisht në të gjithë territorin, me përjashtim vetëm të 6 komunave. Megjithatë Kukësi mund të përshkruhet si një qark me territor të vështirë relievi, shikohet që ka një frekuentim të lartë të arsimit të detyruar, krahasuar kjo me qarqet e tjera. Zonat ku ka një regjistrim të lartë të arsimit të detyruar janë: Kukësi 100%, Bajram Curri 95,54%, Llugaj 92,46%, Bushtrica 90,17%, Tërthore 90,04%. Komunitetet ku ka një regjistrim të ulët të frekuentimit të shkollës janë: Lekbibaj 69,3%, Bytyçi 66,41%, Tropoja-Fshat 63,91%, Surroji 63,23%, Topojani 61,24%, Bujan 57,17%.

Në Qarkun e Kukësit vihet re që në dy zonat urbane të banimit, Bajram Curri dhe Kukës frekuentimi i arsimit të detyruar është në nivel të lartë (Kukësi 100% dhe Bajram Curri 95,54%). Megjithatë nuk mund të themi se komunitetet rreth qendrave urbane të banimit kanë dukshëm një frekuentim të arsimit të detyruar.


Harta 44. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel komune, qarku i Kukësit, viti 2009



7.2.3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm, përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç

Numri i fëmijëve 15-18 vjeç në qarkun e Kukësit raportohet të jetë 7441⁶⁷ për vitin 2009, shifër që përbën 6,96% të popullatës së këtij qarku.

Grafiku 37. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Kukësit, viti 2009




Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

⁶⁷ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm në qarkun e Kukësit është në një situatë disi pozitive, kryesisht në rrethin e Hasit me 70,45%. Në rrethet e tjera, frekuentimi është në shkallë më të ulët, përkatësisht, Tropoja 61,32% dhe Kukësi 56,31%.

Grafiku 38. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm sipas rretheve, qarku i Kukësit, viti 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Kukës dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

7.2.4. Disa probleme për rritjen e frytshmërisë së punës në kopshte dhe në shkollë

- Rritja e frekuentimit të fëmijëve në arsimin parashkollor: 70 % për fëmijët 3-6 vjeç dhe 100 % për fëmijët 5-vjeçare.
- Rritja e cilësisë së mësimdhënies: rritja e numrit të mësuesve me arsim përkatës.
- Shtrirja e sistemit të arsimit profesional dhe orientimi i tij drejt kërkesave të tregut.
- Përmirësimi i efektivitetit të administrimit: 100 % e drejtuesve të shkollave të kenë kryer specializim për drejtimin e administrimit të shkollës.
- Rritja e mundësive financiare të sistemit arsimor: mbi 30 % e buxhetit të qeverisjes vendore të jetë në dispozicion të arsimit.

7.3. Përshkrimi i situatës së fëmijëve romë dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Qarku i Kukësit nuk ka probleme në lidhje me fëmijet romë. Vijueshmëria e nxënësve të kësaj bashkësie në shkollë është e kënaqshme. Gjithsej kemi 58 fëmijë romë që vazhdojnë arsimin e detyruar normalisht.

Një problem që po shfaqet kohëve të fundit, janë fëmijët romë që po vijnë me familjet e tyre nga zona e Elbasanit dhe po vendosen në qytetin e Kukësit për të qenë me afër kufirit me Kosovën për qëllime tregtie.

Kur flasim për mbrojtje sociale, një kategori me nevoja specifike janë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Aktualisht në bashkinë e Kukësit funksionon qendra e shërbimeve sociale, e cila u ka ardhur në ndihmë fëmijëve të kësaj kategorie, sidomos fëmijëve që nuk ndjekin shkollën.

7.4. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Kukësit ka një popullsi prej 106923⁶⁸ banorë dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 27133⁶⁹, nga të cilat 7964 ose 29,35% janë familje të varfra dhe kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç.


⁶⁸ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁶⁹ DRShS, Qarku Kukës.

Në vitin 2009 në qarkun Kukësit kemi një raport tepër problematik, ku 1 në 2 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç jetonte në familje të trajtuara me ndihmë ekonomike.

Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike që kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç në qarkun e Kukësit, paraqitet e lartë në zonat rurale malore, siç janë komunat: Surroji 64,01%, Ujmishti 50,18%, Gjinaj 48,89%, Malziu 46,66%, Fajza 43,53% dhe Zapod-Orgjosti 42,18%.

Harta 45. Përqindja e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, në komunën përkatëse, për vitin 2009.



Burimi. DRShS, Qarku Kukës.

Tabela 26. Komunat me përqindjen më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Surroj	64,01
Ujmisht	50,18
Gjinaj	48,89
Malziu	46,66
Fajza	43,53
Zapod- Orgjost	42,18
Kalis	40,93

Burimi. DRShS, Qarku Kukës.

Tabloja e përqindjes së fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe është më e lartë si në nivel me njësitë e tjera vendore të qarkut, ashtu dhe në nivel kombëtar, në këto zona: Zapod-Orgjost 99,85%, Fierzë 92,11%, Topojan 84,15%, Kukës (bashki) 81,24%, Tërthore 79,68%, Bujan 76,92%, Shtiqën 73,66% dhe Malziu 72,02%.

Harta 46. Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, ndaj totalit të fëmijëve të kësaj grup-moshe në njësinë vendore përkatëse, për vitin 2009.




Tabela 27. Komunat me përqindjen më të lartë të fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Zapod- Orgjost	99,85
Fierzë	92,11
Topojan	84,15
Kukës (bashki)	81,24
Tërthore	79,68
Bujan	76,92
Shtiqën	73,66
Malziu	72,02


Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

7.5. E drejta për kujdes shëndetësor

7.5.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta

Harta 47. Përqindja e fëmijëve <18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel komune për qarkun e Kukësit, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 28. Komunat me përqindjen më të lartë të fëmijëve <18 vjeç me aftësi të kufizuara për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Kukës (bashki)	3,7
Topojan	2,9
Krumë	2,7
Tropojë- Fshat	2,7
Bujan	2,4
Shtiqen	2,2
Bajram Curri	2,2
Bushtricë	2,1
Lekbibaj	2,1
Malziu	2
Llugaj	2
Margegaj	1,9

Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

7.5.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në qark

Harta 48. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me aftësi të kufizuara në nivel rrethi për qarkun e Kukësit, për vitin 2009.



Tabela 29. Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve 15-18 vjeç me aftësi të kufizuara, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Tropojë	2,8
Kukës (rreth)	2,6
Has	2,5


Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

7.5.3. Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në nivel njësie vendore, qarku i Kukësit

Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në njësitë vendore të qarkut të Kukësit (për ato zona që kemi mundur të sigurojmë të dhëna), është 1 (një) infermier për 369 banorë, një raport që është disi afër me standardin kombëtar (një infermier për 270 banorë).

Harta 49. Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në nivel njësie vendore për qarkun e Kukësit, për vitin 2009.



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.


Njësitë vendore që kanë një raport **larg** standardeve kombëtare dhe evropiane, pra që kanë 1 infermier ose mami për më **shumë** se 270 banorë, sipas komunave e bashkive të Kukësit, janë: Shishtavec (1:1,061), Bashkia Kukës (1:931), Shtiqën (1:521), Topojan (1:519), Krumë (1:515), Golaj (1:456), Bajram Curri (1:455), Zapod-Orgjost (1:442), Fajzë (1:415), Tërthorë (1:332), Surroj (1:323), Bicaj (1:306).

Njësitë vendore që kanë një raport **brenda** standardeve kombëtare dhe evropiane, pra që kanë 1 infermier ose mami **për më pak** se 270 banorë, sipas komunave e bashkive të Kukësit, janë: Margegaj me 250, Lekbibaj me 236, Malziu me 225, Tropojë-Fshat me 223, Bushtrica me 219, Bujani me 205, Fierza me 176, Bytyçi me 175, Llugaj me 174.

7.5.4. Raporti 1 (një) mjek për banorë në nivel njësie vendore për qarkun e Kukësit

Raporti mjek për banorë në nivel qarku është 1 (një) mjek për **2228** banorë, ku standardi kombëtar është një mjek për **546** banorë. Numri i mjekëve në komuna është shumë më i vogël, nëse do ta krahasonim atë dhe me numrin e infermierëve për banorë. Në raportin mjek/banorë në komunat e qarkut të Kukësit (për ato zona që kemi mundur të sigurojmë të dhëna), nuk gjejmë ndonjë komunë që të jetë **brenda apo afër** standardeve kombëtare.

Harta 50. Raporti mjek për banorë në nivel njësie vendore për qarkun e Kukësit, për vitin 2009.



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Sic u pasqyrua më sipër, numri i mjekëve që janë në shërbim të banorëve në të gjitha komunat e qarkut të Kukësit, del se është larg standardit kombëtar. Njësitë vendore më shumë problematike janë (komuna apo bashki): Bushtricë (1:4,163), Golaj (1:3,874), Zapod-Orgjosti (1:3,093), Margegaj (1:3,005), Bajram Curri (1:2,728), Shishtavec (1:2,653), Topojan (1:2,597), Fierzë (1:2,464), Llugaj (1:2,260), Krumë (1:2,190), Bicaj (1:2,145), Lekbibaj (1:2,122), Bytyç (1:2,095), Fajza (1:2,077), Bashkia Kukës (1:2,047), Malziu (1:2,025), Tropojë Fshat (1:1,855), Shtiqen (1:1,823), Tërthore (1:1,661), Bujan (1:1,541), Surroj (1:1,130)..

7.6. E drejta për pjesëmarrje

Në Këshillin e Qarkut të Kukësit është ngritur njësia e monitorimit të të drejtave të fëmijëve, ndërsa pranë bashkisë së Kukësit, është ngritur zyra e mbrojtjes së fëmijëve që tashmë ka marrë dhe rolin e një qendre sociale.

Në thuajse të gjitha shkollat e qendrave urbane janë ngritur organizmat e nxënësve, si: qeveria e nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe parlamenti rinor në shkollat e mesme. Por, në përgjithësi, ende nxënësit nuk janë përfshirë në vendimmarrje.

Kapitulli 8


Qarku i Shkodrës⁷⁰



⁷⁰ Specialiste e Observatorit për Qarkun Shkodër është Znj. Anilda Gurakuqi.

8.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Shkodrës numëronte 324119⁷¹ banorë, prej të cilëve 88579 i përkisnin grup-moshës 0-18 vjeç ose 27%⁷².



8.2. E drejta për arsim

E drejta për arsim është një nga të drejtat themelore të individit, e cila duhet të gëzohet si e tillë në mënyrë të njëjtë e të barabartë pa asnjë dallim apo diskriminim, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë e moshës shkollore. Nga ana tjetër, shteti është i detyruar që t'ua respektojë, t'ua mbrojë dhe t'u përmbushë të drejtën për arsimim si një e drejtë themelore e çdo shtetasi.

Në këtë kushte, drejtoria rajonale e arsimit në Shkodër, si dhe zyrat arsimore të rretheve Malësi e Madhe dhe Pukë vazhdojnë të jenë zbatuese të një sërë reformash në arsim, për të përmirësuar cilësinë e të mësuarit në sistemin e arsimit. E drejta për arsimim orientohet drejt ndjekjes së politikave nxitëse për ndjekjen e arsimit parashkollor, për uljen e braktisjes së nxënësve në arsimin e detyrueshëm, për frekuentimin e shkollave profesionale, për kalimin drejt arsimit gjithëpërfshirës edhe për të mbështetur kategoritë e fëmijëve më të marginalizuar.

Gjithashtu, në tri vitet e fundit në qarkun e Shkodrës po praktikohen të ashtuquajturat klasat përgatitore për arsimin parashkollor me synimin e nxitjes së frekuentimit të kësaj shkalle të arsimimit të fëmijëve.

Veçori e këtij raporti është fakti se zyra e Observatorit të Shkodrës ka arritur të mbledhë të dhëna që lidhen drejtpërdrejt me shkallën e regjistrimit të fëmijëve në të tria shkallët e edukimit për dy vitet shkollore të fundit, 2008-2009 dhe 2009-2010. Ky informacion detajohet jo vetëm në nivelin e rretheve, por edhe në nivelin e komunave, duke dhënë mundësinë e analizës krahasuese lidhur me treguesit e mëposhtëm që paraqiten në këtë raport. Analiza e të dhënave që përfshihen në raport, na jep një kuadër më të detajuar rreth nivelit të respektimit të së drejtës për arsimim apo për mosrespektimin e saj.


8.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor (3-6 vjeç)

Përqindja e grup-moshës parashkollore në qarkun e Shkodrës (fëmijët 3-6 vjeç) është në vlerën 5,24% të popullatës, 16987⁷³ fëmijë, duke e bërë këtë qark që të zërë vendin e fundit në lidhje me përqindjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, krahasuar me qarqet e tjera ku zbatohet projekti i Observatorit.

⁷¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁷² Burimi: Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.


⁷³ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 39. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Shkodrës, viti 2009

Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011.

Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor për qarkun e Shkodrës, kemi një tablo me shkallë të ulët regjistrimi, ku nuk ka ndonjë nga rrethet ta ketë më shumë se 50%. Realisht ka një rritje të numrit të fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor nga viti shkollor 2008-2009 në vitin shkollor 2009-2010 dhe kjo në shifra më të larta për rrethin e Malësisë së Madhe, por nëse analizojmë shkallën e regjistrimit neto në këtë sistem, përsëri mbetet në një shkallë frekuentimi jo të kënaqshëm.

Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor në të tria rrethet e qarkut të Shkodrës është e ulët. Konkretisht, Puka 41,8%, Malësia e Madhe 29,49% dhe Shkodra 21,14%. Pra, nëse do të mendonim se shkalla e regjistrimit në parashkollor mund të ishte më e lartë për rrethin e Shkodrës dhe zonat rreth saj, në këtë rast është e anasjella, pasi rrethi i Shkodrës paraqitet problematik, duke pasur përqindjen më të ulët të regjistrimit të fëmijëve në arsimin parashkollor.

Grafiku 40. Shkalla e regjistrimit në arsimin parashkollor në nivel rrethesh, qarku i Shkodrës, viti 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Shkodër dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Në konsultimet me specialistë të DAR-së të Shkodrës, ata janë të bindur se shkalla e frekuentimit të fëmijëve në sistemin parashkollor është e mirë²⁶. Në numrin tërësor të fëmijëve që frekuentojë sistemin parashkollor, përqindjen më të madhe e zë grup-mosha e fëmijëve 5-vjeçar. Ndërsa mosha 3-4 vjeç ka një shkallë të ulët frekuentimi. Ndër të tjera, kjo dukuri lidhet me shkaqet e mëposhtme:

- Papunësia e nënave dhe mos dërgimi i kësaj kategorie të fëmijëve në arsimin parashkollor, pasi parapëlqejnë t'i mbajnë në shtëpi;


- Prania e familjeve me shumë anëtarë, pjesa më e madhe e të cilëve të papunësuar, gjë që ndikon në mbajtjen e fëmijëve në shtëpi, sidomos në zonat rurale.

Vlen të theksohet se hapja e klasave përgatitore për fëmijët 5-vjeçar pranë shkollave të arsimit të detyruar tri vitet e fundit edhe për qarkun Shkodër në kuadër të zbatimit të projektit të MASH-së, për të nxitur ndjekjen e arsimit parashkollor, DAR e qarkut e ka ndjekur problemin me përparësi, duke synuar për hapjen e tyre në të tria rrethet, gjë që ka rritur ndjeshëm nivelin e frekuentimit të arsimit parashkollor. Kështu, në rrethin e Shkodrës raportohet ngritja e 8 klasave përgatitore, të shpërndara respektivisht 5 klasa në territorin e bashkisë së Shkodrës dhe 3 të tjera në komunat Kosmac, Barbullush e Obot. Ndërkohë që priten të hapen edhe 8 klasa të tjera të tilla. Ndërsa në rrethin Malësi e Madhe raportohet të jenë ngritur 2 klasa të tilla²⁶.

8.2.2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar (grup-mosha 6-15 vjeç)

Fëmijët në moshë shkollore përbëjnë një përqindje më të lartë se fëmijët në moshe parashkollore dhe të rinjtë që ndjekin shkollën e mesme në këtë qark, dukuri kjo për të gjitha qarqet e vendit, nga vetë fakti se përfshin një shtrirje më të madhe kohore, krahasuar kjo me dy grup-moshat e tjera të fëmijërisë. Numri i fëmijëve të kësaj grup-moshe për qarkun e Shkodrës është 51314⁷⁴ ose 15,83% e numrit të përgjithshëm të popullatës.

Grafiku 41. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun e Shkodrës, viti 2009




Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Shkodra, një vend me histori arsimit dhe edukimi, të njohura në mbarë vendin, u ka dhënë jetë shumë letrarëve të njohur kombëtarë (Migjeni, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda) paraqet një nivel jo maksimal të ndjekjes së arsimit të detyruar.

Frekuentimi i arsimit të detyruar për qarkun e Shkodrës, ndjek pothuajse të njëjtën kurbë si ai i parashkollorit, ku rrethi me nivel më të lartë regjistrimi është Puka, me 82,82%, i ndjekur nga Shkodra, me 64%, dhe Malësia e Madhe, me 61,56%.

⁷⁴ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 42. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar në secilin rreth, qarku i Shkodrës, viti 2009



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Shkodër dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Në qarkun e Shkodrës të dhënat në nivel komune janë mbledhur kryesisht në të gjithë territorin; përjashtim kemi vetëm për 6 komuna.

Në bashkinë e Shkodrës nuk raportohet të ketë një nivel të lartë të regjistrimit në arsimin e detyruar, duke qenë në vlerën 63,87%.

Sipas DAR-së së Shkodrës, një dukuri e tillë nuk shfaqet për rrethin e Shkodrës. Specialistët e DAR-së vlerësojnë dhe deklarojnë se fëmijët që aktualisht banojnë në territorin e një bashkie ose të një komune, të gjithë janë të përfshirë në sistemin e arsimit të detyruar²⁶.

Duhet theksuar se një përlogaritje e tillë e shkallës së regjistrimit në arsimin e detyruar duhet marrë me rezerva, pasi në këtë përlogaritje nuk janë vlerësuar aspekte të tjera, si: lëvizjet e nxënësve nga brenda vendit jashtë vendit apo migrimi i pakontrolluar i familjeve së bashku me fëmijët nga një qendër banimi në tjetrën.

Komunat që kanë një regjistrim të lartë në këtë qark, janë paraqitur në tabelën më poshtë.


Komuna	Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar
Guri i Zi	73,33
Gruemirë	73,69
Rrethinat	77,28
Hajmel	79,12
Pukë (bashkia)	74,69
Fierzë	100,00
Fushë-Arrëz (bashki)	100,00
Iballë	97,16

²⁶ Nga biseda me specialistë të ZA-së së Malësisë së Madhe, dt. 7.3.2011

²⁷ Nga biseda me specialistin e DAR-së Shkodër, dt. 7.3.2011.

Nga komunat me nivel të lartë të frekuentimit, siç vërehet edhe në tabelë, regjistrohet me vlera 100% bashkia Fushë-Arrës dhe komuna Fierzë. Është për t'u vlerësuar pozitivisht nxitja dhe frekuentimi i shkollës nga fëmijët e këtyre zonave, ku me gjithë kushtet e vështira të territorit malor që kanë, ato del se kanë siguruar suksesshëm pjesëmarrjen në shkollë për të gjithë fëmijët.

Harta 51. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel njësie vendore, qarku i Shkodrës, viti 2009




Ndër njësitë vendore me nivel më të ulët të regjistrimit në arsimin e detyruar, janë komuna e Shalës (53,43%), komuna e Pultit (42,78%), komuna e Shllakut (28,7%), komuna e Qerretit (52,89%) dhe komuna e Dajçit (46,71%).

8.2.3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm (përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç)


Përqindja e grup-moshës 15-18 vjeç, përbën 5,7% të të gjithë popullatës së qarkut të Shkodrës, në numër janë 18465⁷⁶ fëmijë.

⁷⁶ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 43. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Shkodrës, viti 2009

Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Nga kjo grup-moshë, jo të gjithë fëmijët arrijnë të regjistrohen në arsimin e mesëm, duke bërë që qarku i Shkodrës të regjistrojë një shkallë të ulët në masën 50%. Si në arsimin e detyruar, edhe në arsimin e mesëm, rrethi i Pukës vazhdon të ketë nivelin më të lartë (50,4%) mes dy rretheve të tjera, Malësi e Madhe (44,04%) dhe Shkodër (44,84%).

Grafiku 44. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm në rrethe, qarku i Shkodrës, viti 2009

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Shkodër dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

8.3. Përshkrimi i situatës së fëmijëve romë dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara në qarkun e Shkodrës janë pjesë e sistemit të edukimit special, duke qenë të përfshirë vetëm në shkollën speciale "3 Dhjetori" (në qytetin e Shkodrës). Për vitin shkollor 2009-2010, raportohet një shifër prej 86 fëmijëve që ndjekin këtë shkollë. Duhet të theksohet se një shkollë e tillë është e vetmja strukturë për fëmijët me aftësi të kufizuara që funksionon për tërë qarkun.

Në lidhje me integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat dhe shkollat publike, nuk kemi mundur të sigurojmë ndonjë informacion nga zyrat e DAR-së apo të ZA-ve të rretheve. Këto struktura nuk raportojnë rreth numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla, ndonëse pranohet funksionimi i klasave të integruara për fëmijë me aftësi të kufizuara. Çështja e integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasa të integruara lidhet me shumë më dëshirën e mirë të disa mësuesve sesa shihet si një detyrim ligjor⁷⁷.

Fëmijët me aftësi të kufizuara përbëjnë një kategori problematike më vete, pasi janë fëmijë që përballen me vështirësi të ndryshme, duke filluar nga zhvillimi i vonshëm, të meta fizike etj.

⁷⁷ Draft "Strategjia rajonale e fëmijëve të qarkut të Shkodrës"

Më shumë vëmendje duhet kushtuar në drejtim të identifikimit të tyre dhe zbatimit të politikave favorizuese lidhur me mirërritjen dhe arsimimin e tyre gjithëpërfshirës.

Integrimi i fëmijëve romë në të gjitha shkallët e arsimit mbetet një përparësi për punën e DAR-së së Shkodrës. Falë politikave favorizuese, situata e arsimit të fëmijëve që i përkasin të komunitetit egjiptian paraqitet e mirë dhe si e tillë mund të flitet për integrim të këtyre fëmijëve.

Ndërsa mbeten për t'u adresuar problematikat që lidhen me arsimimin e fëmijëve të komunitetit rom, të cilët nuk kanë frekuentuar ndonjëherë institucionet e edukimit. Veçoria e këtij komuniteti është se ai nuk ka vendbanim të qëndrueshëm, duke u klasifikuar si komunitet lëvizës. Ky komunitet në mjaft raste nuk figuron fare i regjistruar, ndonëse raportohet të jetë vendosur aktualisht në një zonë të caktuar të bashkisë së Shkodrës (buzë liqenit), pavarësisht përpjekjeve pozitive të këtij institucioni për t'i regjistruar dhe për t'u ofruar mundësi integrimi, sidomos fëmijëve. Nga ana e administratës së qarkut, është realizuar një projekt i veçantë për njohjen e gjendjes dhe përfshirjen e fëmijëve në projektin e arsimit "Shansi i dytë".

8.4. Mendime e propozime të përgjithshme

1. Politika favorizuese në nivel qarku, për të ndërgjegjësuar popullsinë në lidhje me ndjekjen e vitit parapërgatitor të shkollimit, që në moshën 5 vjeç, si vazhdimësi e politikave të klasave përgatitore të ngritura tashmë nga MASH me propozim të DAR-së dhe të ZA-ve në rrethe.
2. Zgjerimi i klasave përgatitore edhe në komuna apo në njësi të tjera vendore, duke rritur shkallën e regjistrimit të fëmijëve në arsimin parashkollor.
3. Sigurimi i shërbimeve të fëmijërisë së hershme, sidomos tek grupet e marginalizuara dhe në zonat e varfra.
4. Arsim gjithëpërfshirës për fëmijët më aftësi të kufizuara në klasa apo në shkolla të integruara.
5. Nxitje për rritjen e shkallës së frekuentimit në arsimin e detyruar dhe në arsimin e mesëm, përfshirë edhe arsimin profesional.
6. Politika favorizuese për përfshirjen e fëmijëve romë në sistemin edukativ.
7. Nxitja e politikave të reja për realizimin e së drejtës për arsimim të fëmijëve, që mund t'u jetë mohuar kjo e drejtë, për shkak të përfshirjes në punë të fëmijëve apo nga dukuri të tjera negative, qoftë edhe nga varfëria, si dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit të prindërve dhe i komunitetit për rëndësinë e arsimit të fëmijëve.

8.5. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Shkodrës ka një popullsi prej 234113⁷⁸ banorësh dhe një numër të përgjithshëm prej 95905, familjesh, nga të cilat 9893⁷⁹ ose 10,32% janë familje të varfra dhe kanë fëmijë të grup-moshave 0-15 vjeç.

Në vitin 2009 në qarkun e Shkodrës 1 në 5 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç jetonte në familje, të cilat trajtoheshin me ndihmë ekonomike.

Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike që kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç në qarkun e Shkodrës, paraqitet më e lartë në zonat e thella rurale, siç janë: komuna e Shllakut me 48,36%, komuna e Temalit me 43,42%, komuna e Qerretit me 41,91%, komuna e Pultit me 38,55%, komuna e Vig-Mnellës me 37,37% dhe komuna e Shkrelit me 32,45%.

⁷⁸ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁷⁹ DRSHS, Qarku Shkodër.

Harta 52. Përqindja e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, në secilën njësi vendore përkatëse, për vitin 2009.




Tabela 30. Komunat me përqindjen më të lartë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike me fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.

Komuna	Përqindja
Shllak	48,36
Temal	43,42
Qerret	41,91
Pult	38,55
Vig- Mnellë	37,37
Shkrel	32,45
Shosh	28,71
Qafë- Mali	26,81
Postrisë	25,09
Shalë	23,43
Fierzë	23,28

Burimi. DRShS, Qarku Shkodër.

Burimi. DRShS, Qarku Shkodër.

Tabloja në vazhdim pasqyron përqindjen e fëmijëve të moshës 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike. Duke parë tabelën, del se, në krahasim me komunat e tjera të qarkut, përqindjen më të lartë të familjeve me NE dhe fëmijë, e kanë dy komunat: Shkrel me 47,43% dhe Pulti me 42,06%. Analiza e të dhënave tregon që në bashkinë e Fushë-Arrëzit (me 93,66%) dhe në komunën e Fierzës (me 90,87%) gati të gjithë fëmijët e grup-moshës 6-15 vjeç jetojnë në familje të varfra.

Harta 53. Përqindja e fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike, ndaj numrit të përgjithshëm të fëmijëve të kësaj grup-moshe në njësinë vendore përkatëse, për vitin 2009.




Tabela 31. Njësitë vendore me përqindjen më të lartë të fëmijëve 6-15 vjeç, familjet e të cilëve janë të varfra (që trajtohen me ndihmë ekonomike), për vitin 2009.

Komuna	Përqindja
Fushë- Arrëz	93,66
Fierzë	90,87
Hajmel	51,48
Shllak	51,48
Gjegjan	49,15
Shkrel	47,43
Pult	42,06
Vau i Dejës	31,66


Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DRShS në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

8.6. E drejta për kujdes shëndetësor

8.6.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta

Harta 54. Përqindja e fëmijëve <18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel njësie vendore për qarkun e Shkodrës, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSSH, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.


Tabela 32. Njësitë vendore me përqindjen më të lartë të fëmijëve <18 vjeç me nevoja të veçanta, për vitin 2009.

Komuna	Përqindja
Pult	7.3
Shalë	6.6
Iballë	5.6
Fierzë	5
Shllak	4.8
Hajmel	3.8
Shkrel	3.5
Fushë- Arrëz	2.6
Shkodër (bashki)	2.6
Pukë (bashki)	2.3
Vau i Dejës	2.1
Postribë	1.9

Burimi. MPÇSSH, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

8.6.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta sipas rretheve

Harta 55: Përqindja e fëmijëve (15-18 vjeç) me nevoja të veçanta në nivel rrethi për qarkun e Shkodrës, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 33: Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta, për vitin 2009.


Rrethi	Përqindja
Malësi e Madhe	2,3
Pukë	2,1
Shkodër (rreth)	1,8

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

8.6.3. Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në nivel njësie vendore, qarku i Shkodrës

Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në njësitë vendore të qarkut të Shkodrës (për ato zona që kemi mundur të sigurojmë të dhëna), është mbi standardin kombëtar. Në nivel qarku ky raport është 1 (një) infermier për **626** banorë, ku standardi kombëtar është një infermier për 270 banorë.

Harta 56. Raporti 1 (një) infermier ose mami për banorë në nivel njësie vendore për qarkun e Shkodrës, për vitin 2009.




Njësitë vendore, të cilat kanë një raport **mbi** standardin kombëtar dhe shumë më tepër se standardi evropian, pra që kanë 1 infermier ose mami për më **shumë** se 270 banorë, sipas njësive vendore të Shkodrës, janë: Kopliku (1 infermier për 1575 banorë), Bashkia Shkodër (1:874), banorë, Guri i Zi (1:849), Rrethina (1:831), Bushat (1:783), Velipojë (1:778), Bërdicë (1:639), Dajç (1:610), Hajmel (1:544), Postribë (1:508), Vau i Dejës (1:483), Ana e Malit (1:446), Shalë (1:418), Pult (1:382), Shkrel (1:362), Bashkia Pukë (1:282).

Njësitë vendore të qarkut të Shkodrës, të cilat kanë një raport **brenda** standardeve kombëtare dhe evropiane, pra që kanë 1 infermier ose mami **për më pak** se 270 banorë, janë: Shllaku (1 infermier për 267 banorë), Gjegjan (1:236), Qerret (1:164), Fushë-Arrëz (1:157), Iballë (1:118) and Fierzë (1:118).

8.6.4. Raporti i mjekëve për banorë në nivel njësie vendore, qarku i Shkodrës

Në nivel qarku, në Shkodër ka 1 (një) mjek për **2947** banorë, kur standardi kombëtar është një mjek për **546** banorë. Numri i mjekëve në komuna (për ato zona që kemi arritur të sigurojmë të dhëna), është edhe shumë më i vogël, nëse do ta krahasonim atë dhe me numrin e infermierëve për banorë. Edhe në këtë qark, për raportin mjekë/banorë nuk gjejmë ndonjë komunë që të jetë **afër apo brenda** standardeve kombëtare.

Harta 57. Raporti 1 (një) mjek për banorë në nivel njësie vendore për qarkun e Shkodrës, për vitin 2009.




Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Numri i mjekëve që janë në shërbim të banorëve në njësitë vendore të Qarkut të Shkodrës, në të gjitha komunat është larg standardit kombëtar, 546 banorë për një mjek. Njësitë vendore (komuna e bashki) më shumë problematike janë: Gjegjani (1 mjek për 4486 banorë), Bushat (1:3,783), Koplik (1:3,675), Pult (1:3,054), Bërdicë (1:2,983), Vau i Dejës (1:2,900), Qerret (1:2,868), Velipojë (1:2,853), Dajç (1:2,849), Postribë (1:2,794), Guri I zi (1:2,760), Hajmel (1:2,722), Shalë (1:2,505), Bashkia Shkodër (1:2,414), Iballë (1:2,124), Ana e Malit (1:1,931), Shkrel (1:1,931), Bashkia Pukë (1:1,836), Shllak (1:1,599), Fushë Arrëz (1,477), Fierë (1:1,059).

8.6.5. Numri i konsultoreve për fëmijë, qarku i Shkodrës


Për qarkun e Shkodrës kemi siguruar të dhëna për pjesën më të madhe të territorit në lidhje me numrin e konsultoreve për fëmijë. Nga pasqyrimi në hartë, shikohet që kryesisht të gjitha komunat e rrethit të Shkodrës kanë nga një konsultore për fëmijë. Bashkia e Fushë-Arrëzit ka vetëm një qendër shëndetësore dhe në territorin e saj banojnë 1225 fëmijë <18 vjeç, duke krijuar kushte të vështira për ndjekjen e tyre mjekësore dhe realizimin e shërbimeve të tjera për ta. Komuna e Gjegjanit ka 9 konsultore për 1445 fëmijë, në raportin një konsultore për 160 fëmijë. Në bashkinë e Koplikut, territor në të cilin jetojnë 3078 fëmijë, nuk kemi të dhëna të plota, pasi nuk raportohet të ketë ndonjë qendër shëndetësore.

Harta 58. Numri i konsultoreve për fëmijë në nivel njësie vendore për qarkun e Shkodrës, për vitin 2009.



Burimi. DRShS, Qarku Shkodër.

Grafiku 45. Paraqitja grafike e numrit të konsultoreve për fëmijë në nivel njësie vendore për qarkun e Shkodrës (në këtë grafik pasqyrohen vetëm ato komuna e bashki për të cilat kemi arritur të sigurojmë të dhëna).



Burimi. DRShS, Qarku Shkodër.

8.6.6. Shkalla e imunizimit, qarku i Shkodrës

Shkalla e Imunizimit për Qarkun e Shkodrës, vazhdon të jetë në parametra maksimal mbi 97%, ku Rrethi i Malësisë së Madhe regjistron shkallën e regjistrimit 100%.

Harta 59. Shkalla e imunizimit në qarkun e Shkodrës në nivel rrethi, për vitin 2009.




Tabela 34. Shkalla e imunizimit në qarkun e Shkodrës në nivel rrethi, për vitin 2009.

Rrethi	Shkalla e Imunizimit
Malësi e Madhe	100
Shkodër (Rreth)	97,32
Pukë	98,2

Burimi. DShP-ja e qarkut të Shkodrës, janar 2011.

Burimi. DShP-ja e qarkut të Shkodrës, janar 2011.

8.7. E drejta për pjesëmarrje

E drejta e fjalës, e shfaqjes lirisht të mendimit janë të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Konventën për të drejtat e fëmijëve. Një formë e pjesëmarrjes së fëmijëve është edhe ngritja e funksionimi pranë shkollave 9-vjeçare të qeverive të nxënësve dhe pranë shkollave të mesme të parlamenteve rinore. Realisht këto forma organizimi janë të njohura si nga DAR-ja, edhe nga shoqëria civile, që tregon një përpjekje për të fuqizuar këto struktura dhe si të tilla duhen vlerësuar. Por nga vëzhgime të terrenit dhe me grupet e interesit, del se ende nuk ka një kuptim të mirëfilltë e në detaje të të drejtave të tyre, sidomos të qeverive të nxënësve si nga organet drejtuese të arsimit, edhe nga vetë nxënësit. Përgjithësisht, ato funksionojnë si organizma për të shkëmbyer ndonjë mendim për çështje jothelbësore të jetës së fëmijëve dhe të rinjve në shkollë e jashtë saj. Prandaj, ka ardhur koha që qeveritë e nxënësve dhe parlamentet rinore të kenë një rol parësor në veprimtarinë e institucioneve arsimore. Kjo kërkon që në të ardhmen të tregohet më shumë vëmendje drejt përfshirjes së tyre në vendimmarrje, si dhe në zgjerimin e fushës së të drejtave dhe të përgjegjësisë të qeverisë së nxënësve e të parlamenteve rinore; nxitjes se nismave dhe të pavarësisë se këtyre strukturave nga drejtorja e shkollës apo autoritetet lokale.

Kapitulli 9


Qarku i Vlorës⁸⁰



⁸⁰ Specialiste e Observatorit për Qarkun Vlorë është Znj. Jonida Rustemaj.

9.1. Popullsia

Në vitin 2009, qarku i Vlorës numëronte 366300⁸¹ banorë, prej të cilëve 91722 i përkisnin grup-moshës 0-18 vjeç ose 25%²⁹.




9.2. E drejta për arsim

9.2.1. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin parashkollor, grup-mosha 3-6 vjeç, viti 2009

Në qarkun e Vlorës, numri i fëmijëve 3-6 vjeç në vitin 2009 ishte 16440⁸² ose i shprehur në përqindje, fëmijët e grup-moshës parashkollore përbëjnë 5,03% të popullatës, duke e bërë këtë qark që të zërë vendin e fundit në lidhje me përqindjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, krahasuar me qarqet e tjera ku vepron Observatori.

Grafiku 46. Përqindja e popullatës 3-6 vjeç në qarkun e Vlorës, viti 2009



Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011


Në lidhje me regjistrimin e fëmijëve 3-6 vjeç në sistemin e arsimit parashkollor për qarkun e Vlorë, momentalisht ballafaqohemi me një mungesë të dhënash në dy nga tri rrethet që ka ky qark. Të dhënat mungojnë për rrethin e Delvinës dhe të Sarandës. Ndërsa për rrethin e Vlorës, shkalla e regjistrimit në parashkollor paraqitet shumë e ulët, në vlerën 33,85%.

9.2.2. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e detyruar (6-15 vjeç)

Si në qarqet e tjera dhe në këtë qark, fëmijët në moshë shkollore përbëjnë një përqindje më të lartë se fëmijët në parashkollor dhe të rinjtë që ndjekin shkollën e mesme.

⁸¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.


⁸² Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

Grafiku 47. Përqindja e popullatës 6-15 vjeç në qarkun e Vlorës, viti 2009

Burimi. Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Mainistria e Brendshme, janar 2011

Frekuentimi i arsimit të detyruar për qarkun e Vlorës mbetet që të gjykohet vetëm për rrethin e Vlorës, pasi të dhënat për rrethin e Delvinës dhe të Sarandës mungojnë. Përqindja e fëmijëve të grup-moshës që ndjekin arsimin e detyruar për këtë rreth, paraqitet shumë e ulët, gati në masën 50%. Rrethi i Vlorës ka një shkallë regjistrimi 49,35%. E interpretuar ndryshe, kjo e dhënë tregon se 50% të fëmijëve të kësaj grup-moshe nuk dihet nëse e ndjekin arsimin e detyruar.

Përqindja e fëmijëve që ndjekin arsimin e detyruar paraqitet e ulët edhe në nivel komune. Në hartë komunat që janë shënuar me një përqindje më të lartë, shikohet që janë rreth vlerës 50%. Kështu, kemi komunat Kotë 60,02%, Brataj 57,2%, Qendër 53,78% dhe Sevaster 53,36%.

Harta 60. Shkalla e regjistrimit në arsimin e detyruar në nivel komune, qarku i Vlorës, viti 2009


Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DAR - Vlorë dhe Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Njësitë vendore me nivel më të ulët të regjistrimit në arsimin e detyruar janë: bashkia e Himarës me 19,84% dhe komunat Shushicë 39,36 % e Selenicë 33,33%.

9.2.3. Shkalla e regjistrimit neto në arsimin e mesëm, përkatësisht grup-mosha 15-18 vjeç

Përqindja e grup-moshës 15-18 vjeç përbën 5,19% të të gjithë popullatës së qarkut të Vlorës.

Grafiku 48. Përqindja e popullatës 15-18 vjeç në qarkun e Vlorës, viti 2009



Burimi: Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, Ministria e Brendshme, janar 2011

Në lidhje me regjistrimin në sistemin e arsimit të mesëm për qarkun e Vlorë, vazhdojmë të hasim po të njëjtin problem, kemi mundur të sigurojmë vetëm të dhëna për rrethin e Vlorës, pasi mungojnë të dhënat për 2 rrethet e tjera: të Delvinës dhe të Sarandës. Ndërsa shkalla e regjistrimit prezantohet e ulët, në vlerën 47,15%.

9.2.4. Disa probleme që ndeshim në realizimin e të drejtës për arsim

- Gjatë zbatimit të vitit të parë të projektit në qarkun e Vlorës, kemi hasur vështirësi me strukturat vendore dhe më konkretisht me DAR-në. Kjo zyrë nuk pranon të bashkëpunojë me Observatorin për përcjelljen e të dhënave, duke vendosur si kusht bashkëpunimi një marrëveshjet të hartuar më parë me MASH.
- Ka një mungesë të theksuar të të dhënave në sistem database nga institucionet lokale. Kështu, treguesit e përcaktuar nga Observatori nuk mblidhen të plota për institucionet vendore (në nivel komune dhe bashkie) për vitet shkollare 2008-2009, 2009-2010.
- Gjatë mbledhjes dhe ballafaqimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet lokale, vihet re një përplasje mes të dhënash. Kjo përplasje ndikon në mospasjen e një informacioni të saktë dhe bashkërendues me institucionet e tjera.
- Në lidhje me treguesin "Numri i nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin përkatës" nuk kemi gjetur të dhëna si tregues pune për zyrat lokale arsimore.

9.3. E drejta për mbrojtje sociale

Qarku i Vlorës ka një popullsi prej 238552⁸³ banorësh dhe një numër të përgjithshëm familjesh prej 60478⁸⁴ vetëm në rrethin e Vlorës, nga të cilat 106, po të rrethit të Vlorës, janë familje të varfra dhe kanë fëmijë të grup-moshës 0-15 vjeç.

Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihme ekonomike dhe kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç – Vlorë, paraqitet në hartën dhe tabelën më poshtë.

⁸³ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Janar 2011.

⁸⁴ DRShS, Qarku Vlorë.



Burimi: DRShS, Qarku Vlorë.


Tabela 35. Rrethet e qarkut të Vlorës me përqindjet përkatëse të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe kanë fëmijë 0-15 vjeç, për vitin 2009.

Rrethi	Përqindja
Vlorë (rreth)	0,18

Burimi. DRShS, Qarku Vlorë.

9.5. E drejta për kujdes shëndetësor

9.5.1. Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me nevoja të veçanta



Burimi: MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 36. Njësitë vendore me përqindjen më të lartë të fëmijëve <18 vjeç me nevoja të veçanta, për vitin 2009.

Njësia vendore	Përqindja
Sevaster	1,7
Vllahinë	1,5
Delvinë (bashki)	1,2
Sarandë (bashki)	1,2
Vlorë (bashki)	1,2
Xarë	1,1
Dhivër	0,9

Burimi. MPÇSShB, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

9.5.2. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në qark

Harta 63. Përqindja e fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta në nivel Rrethi për qarkun e Vlorës, për vitin 2009.



Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

Tabela 37: Rrethet me përqindjen përkatëse të fëmijëve 15-18 vjeç me nevoja të veçanta, për vitin 2009.


Rrethi	Përqindja
Vlorë (rreth)	1,5
Sarandë	1
Delvinë	0,6

Burimi. MPÇSSHb, Shërbimi Social Shtetëror, prill 2011.

9.5.3. Raporti 1 mjek për banorë në qarkun e Vlorës

Raporti i mjekëve për banorë në nivel qarku është 1 (një) mjek për **2930** banorë, kur standardi kombëtar është një mjek për **546** banorë. Numri i mjekëve në njësitë vendore (për ato zona që kemi siguruar të dhëna), është shumë më i vogël, nëse do ta krahasonim atë dhe me numrin e infermierëve për banorë. Në raport mjek/banorë nuk gjejmë ndonjë komunë që të jetë **afër apo brenda** standardeve kombëtare edhe në këtë qark.

Harta 64. Raporti mjek për banorë në nivel komune për qarkun e Vlorës, për vitin 2009.



Burimi. Të dhënat janë përpunuar nga zyra e Observatorit Tiranë, sipas informacionit të marrë nga DShP në Qark dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

Numri i mjekëve që janë në shërbim të banorëve në të gjitha komunat e qarkut të Vlorës shikohet të jetë larg standardit kombëtar, një mjek për 546 banorë. Zonat më shumë problematike (komuna dhe bashki) janë: Xara (1:7,355), Mesopotam (1:6,158), Ksamil (1:4,386), Bashkia Sarandë (1:4,379), Himarë (1:4,348), Vergoi (1:4,160), Bashkia Delvinë (1:3,523), Armen (1:3,452), Dhivër (1:3,393), Finiq (1:3,296), Sevaster (1:3,291), Markat (1:3,113), Lukovë (1:3,092), Konispol (1:3,055), Orikum (1:2,757), Bashkia Vlorë (1:2,639), Qendër (1:2,556), Selenicë (1:2,333), Shushicë (1:2,317), Novoselë (1:2,302), Vllahinë (1:2,160), Kote (1:2,145), Hore Vranisht (1:2,040), Brataj (1:1,687).

9.5.4. Shkalla e imunizimit sipas rretheve

Për qarkun e Vlorës, vetëm për rrethin e Sarandës kemi informacion në lidhje me shkallën e imunizimit. Ky rreth prezantohet në një nivel të lartë, në masën 96%.

Harta 65. Shkalla e imunizimit në qarkun e Vlorës në nivel rrethi, për vitin 2009 (ka të dhënë vetëm për rrethin e Sarandës).



Tabela 39. Shkalla e imunizimit në qarkun e Vlorës në nivel rrethi, për vitin 2009.

Rethi	Shkalla e imunizimit
Sarandë	96%

Burimi: DShP-ja në Vlorë, janar 2011.

Burimi. DShP-ja në Vlorë, janar 2011.

Rekomandime

- Ti kushtohet vëmendje planit të edukimit për arsimin e detyruar, duke u mbështetur në gjendjen reale të çdo njësie vendore, si dhe të pasqyrojë lëvizjet e sakta (largimet dhe ardhjet) për çdo fëmijë të grup-moshës 6-16 vjeç.
- Në komuna mungojnë pothuajse fare institucione arsimore të parashkollorit ose ato janë në gjendje tejet të amortizuara dhe aspak të sigurta dhe argëtuese për fëmijët e kësaj grup-moshe.
- Të rriten nismat lokale për informimin dhe ndërgjegjësimin e prindërve për rëndësinë e frekuentimit të arsimit parashkollor.
- Të rritet vëmendja e strukturave të pushtetit lokal (kryesisht në nivel komune) për rëndësinë e strukturave parashkollore, me qëllim që të rriten investimet në këtë sektor.
- Të ndërmerren veprime konkrete për forcimin e pjesëmarrjes së nxënësve në zgjidhjen e problemeve deri në vendimmarrje, nëpërmjet qeverive të nxënësve, parlamenteve rinore e organizmave të tjera.
- Të gjejë zbatim Ligji për dhënien e informacionit nga të gjitha njësitë vendore dhe organet vendore të arsimit, të shëndetësisë, të përkrahjes sociale etj.
- Të synohet për rritjen e autoritetit vendimmarrës të institucioneve shkollore deri në planifikimin dhe realizimin e buxhetit, nëpërmjet decentralizimit.
- Riorganizimi i Ligjit dhe i skemës së përfituesve të ndihmës ekonomike (NE). Duke qenë se ende Ligji për NE⁸⁵ nuk përfshin në skemë familjet e zhvendosura pas vitit 1991 në zona të ndryshme të vendit, bën që shumë familje, megjithëse mund të plotësojnë të gjitha kriteret e një familjeje të varfër, mbesin jashtë skemës së përfitimit për shkak të zhvendosjes nga vend banimi i tyre në një vendbanim të ri pas vitit 1991.
- Nevoja për të përmirësuar sistemin e informacionit që adreson grupet vulnerable.
- Reagimi ndaj problemeve sociale të reja të grupeve të prekshme (skema përftimesh) dhe diversifikimi i shërbimeve.
- Nevoja për integrim të institucioneve të sistemit në nivel lokal dhe bashkëpunim më të mirë aktorëve kryesorë, duke bërë sistemin që të funksionojë si një i vetëm.
- Përqindja e lartë e fëmijëve që jetojnë në familje të varfëra (që trajtohen me NE), kryesisht në qarqet Kukës dhe Dibër, dikton ofrimin e shërbimeve sociale, me qëllim parandalimin e fëmijëve vulnerabël dhe të marginalizuar në një të ardhme të afërt.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të stafit lokal për të marrë përgjegjësi për të ofruar shërbime sociale.
- Alokim fondesh në nivel lokal për shërbime sociale.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Tiranë

10 maj 2011

⁸⁵ Ligji nr. 7710, dt. 18/ 05/ 1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shëndetësor".

